FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 7	2000	Prill

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr. 8584, datë 15.3.2000	Për disa shtesa dhe ndryshimet në ligjin nr.8339, datë 30.4.1998 "Për krijimin e agjencisë së trajtimit të kredive"	245
Ligj nr.8585, datë 15.3.2000	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën "Për mbrojtjen e prodhuesve të fonogrameve kundër riprodhimit të paautorizuar të tyre"	247
Ligj nr.8586, datë 15.3.2000	Për ratifikimin e marrëveshjes së garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për rindërtim dhe zhvillim (BERZH), në kuadrin e marrëveshjes së huasë, ndërmjet Kesh-it dhe Berzh-it për financimin e projektit "Rindërtimi i sektorit të energjisë"	252
Ligj nr.8587, datë 15.3.2000	Për disa shtesa në ligjin nr.8433, datë 21.12.1998 "Për përcaktimin e formës dhe të strukturës së formulës së privatizimit të Bankës Kombëtare Tregtare sh.a"	273

Ligj nr.8588, datë 15.3.2000	Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë	274
Ligj nr.8590, datë 23.3.2000	Për miratimin e "Marrëveshjes së koncesionit të formës "bot" për uzinën e ferrokromit në Elbasan dhe për minierat e kromit të Prrenjasit e Pojskës, ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe shoqërisë italiane Darfo s.p.a" dhe dhënien e disa stimujve dhe garancive për koncesionarin e kësaj marrëveshjeje	281
Dekret nr.2564, datë 25.2. 2000	Për emërimin e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese	299
Dekret nr.2586, datë 29.3. 2000	Për lënie të shtetësisë shqiptare	300
Vendim i Kuvendit Nr.434, datë 1.3.2000	Për shqyrtimin me procedurë të përshpejtuar të projektligjit "Për disa shtesa në ligjin nr.8433, datë 21.12.1998 "Për përcaktimin e formës dhe strukturës së formulës të privatizimit të Bankës Tregtare sh.a"	301
Vendim i Kuvendit Nr.435, datë 20.3.2000	Për caktimin e deputetëve që do të marrin pjesë në komisionin për deklarimin e pasurive të të zgjedhurve dhe të disa drejtuesve e punonjësve të shërbimit publik	301
Vendim i Kuvendit Nr.436, datë 30.3.2000	Për zgjedhjen e komisionerëve pranë Avokatit të Popullit	302
Vendim i KM Nr.102, datë 9.3.2000	Për një shtesë në vendimin nr.160, datë 9.7.1975, të Këshillit të Ministrave, " Për normat e furnizimit të ushqimit në ushtri"	303
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të Pëllumb Memës	303

LIGJ
Nr. 8584, datë 15.3.2000

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIMET NË LIGJIN NR.8339, DATË 30.4.1998 "PËR KRIJIMIN E AGJENCISË SË TRAJTIMIT TË KREDIVE"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:

Në ligjin nr.8339, datë 30.4.1998 "Për krijimin e Agjencisë së Trajtimit të Kredive" bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 2, në fjalinë e parë, fjalët "… person juridik shtetëror…" zëvendësohen me fjalët "… person juridik publik, me vetëfinancim…".

Neni 2

Në nenin 3, pas shkronjës "b" shtohet shkronja "c" me këtë përmbajtje:
"Në rastet e përfundimit të procesit të privatizimit të një banke tregtare të nivelit të dytë, me kapital tërësisht shtetëror, me urdhër të ministrit të Financave, Agjencia trajton të gjitha detyrimet që rrjedhin nga kreditë e dhëna nga banka përkatëse, pavarësisht nga burimi i kredisë."

Neni 3

Në nenin 4, pas paragrafit të fundit, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:
"Në rastin e privatizimit të bankave tregtare të nivelit të dytë, me kapital tërësisht shtetëror, Agjencia merr në dorëzim praktikat e kredive, si dhe tepricat e llogarive për secilën prej tyre, sipas gjendjes së pasqyruar në bilancin e paraqitur për privatizimin e bankës përkatëse."

Neni 4

Në nenin 5 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:
"Kreditë e pakthyera tej afateve të përcaktuara në marrëveshjet përkatëse vlerësohen si tituj ekzekutivë."

Neni 5

Në nenin 11, pas fjalëve "… të shkronjës "b"" shtohen fjalët "dhe "c"…"

Neni 6

Në nenin 21, pika 3 ndryshohet si vijon:

“Me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm miraton kushtet e përgjithshme të marrjes në punë, sipas kërkesave të ligjit “Për statusin e nëpunësit civil”, pagën, strukturën dhe numrin e personelit të Agjencisë.”

Neni 7

Në nenin 24, dy fjalitë e fundit të paragrafit të parë, shfuqizohen.

Neni 8

Në nenin 25, në rreshtin e parë, fjalët “si person juridik shtetëror”, zëvendësohen me fjalët “si person juridik publik me vetëfinancim.”

Neni 9

Pas nenit 28, shtohet neni 28/a me këtë përmbajtje:

“1. Buxheti i Agjencisë miratohet nga ministri i Financave brenda muajit janar të çdo viti.

2. Të ardhurat që realizon Agjencia gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj derdhen në buxhetin e shtetit, përveç atyre që parashikohen në pikën 3 të këtij neni dhe atyre që detyrohet t'i kthejë bankave tregtare të nivelit të dytë me kapital tërësisht shtetëror, në rastin kur Agjencia kryen rolin e agjentit.

3. Nga të ardhurat që realizon Agjencia gjatë ushtrimit të veprimtarisë, ajo ka të drejtë të përdorë për të përballuar nevojat e saj, këto fonde:

a) 20 për qind të arkëtimeve që rrjedhin nga shlyerja e kredive;

b) komisioni prej 1.5 për qind në vit mbi pasivet që i detyrohen palëve të huaja;

c) interesat e arkëtuar prej fondeve të veta, të depozituara në bankat tregtare të nivelit të dytë. Agjencia bën depozitimin e shumave, sipas kësaj pike, pasi të ketë marrë me shkrim të paktën 3 (tri) oferta nga bankat tregtare të nivelit të dytë, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Republikën e Shqipërisë;

ç) komisionet e përcaktuara në marrëveshje me bankat tregtare të nivelit të dytë me kapital tërësisht shtetëror, kur Agjencia vepron si agjente e bankave, sipas parashikimeve të këtij ligji;

të ardhura të tjera.

Neni 10

Në nenin 29, paragrafi i parë ndryshohet si vijon:

“Paga e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.”

Neni 11

Në nenin 31, në paragrafin e dytë, në rreshtin e katërt, pas fjalëve “… të shkronjës “b” shtohen fjalët “dhe “c” …”

Neni 12

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2577, datë 27.3.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

LIGJ
Nr. 8585, datë 15.3.2000

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KONVENTËN "PËR MBROJTJEN E PRODHUESVE TË FONOGRAMEVE KUNDËR RIPRODHIMIT TË PAAUTORIZUAR TË TYRE"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në Konventën e 29 tetorit 1971 "Për mbrojtjen e prodhuesve të fonogrameve kundër riprodhimit të paautorizuar të tyre".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2576, datë 27.3.2000, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

KONVENTA PËR MBROJTJEN E PRODHUESVE TË FONOGRAMEVE KUNDËR RIPRODHIMIT JO TË AUTORIZUAR TË TYRE

29 tetor 1971

Shtetet kontraktuese,

Të preokupuara nga shtrirja në rritje e riprodhimit jo autorizues të fonogrameve e dëmi që rezulton në mbrojtjen e të drejtave të autorëve, artistëve interpretues e prodhuesve të fonogrameve;

Të bindur që mbrojtja e prodhuesve të fonogrameve kundrejt të tilla veprimeve do t'i shërbejë gjithashtu interesave të artistëve interpretues dhe autorëve që, ekzekutimet si dhe veprat e tyre, janë regjistruar në të ashtuquajtura fonograme;

Duke njohur vlerën e punës së realizuar në këtë fushë nga Organizata e Shteteve të Bashkuara për edukimin, shkencën, kulturën e Organizatën Botërore të Pasurisë Intelektuale;

Të shqetësuar për mos zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare në fuqi e veçanërisht zbatimi i Konventës së Romës së 26 tetorit 1961 që i jep një mbrojtje artistëve interpretues e organizmave radiodifuzuese, ashtu si dhe prodhuesve të fonogrameve;

Ranë dakord si më poshtë vijon:

Neni 1

Për qëllim të Marrëveshjes në fjalë, nënkupton me:

a) "fonograme" çdo fiksim (vendosje) ekskluzivisht sonor i tingujve që rrjedhin nga tinguj të tjerë:

b) "prodhues të fonogrameve", një person fizik ose juridik i cili, për herë të parë fikson tingujt që vijnë nga ekzekutimi ose nga tinguj të tjerë;

c) "kopje" mbajtëse të tingujve të marra direkt ose indirekt nga një fonogram e që përfshin totalin ose një pjesë substanciale të tingujve të fiksuara në fonograme;

d) "shpërndarje në publik", çdo veprim që kryhet për ofrimin e kopjeve, direkt ose indirekt publikut në përgjithësi ose në pjesë më të vogla.

Neni 2

Çdo shtet kontraktues angazhohet në mbrojtjen e prodhuesve të fonogrameve, që i përkasin vendeve të tjera kontraktuese, kundër kopjeve të prodhuara pa marrë pëlqimin e prodhuesit, kundër importimit të të tilla kopjeve, si dhe kundër shpërndarjes së këtyre kopjeve në publik.

Neni 3

Mënyra e aplikimit të Marrëveshjes në fjalë, i përket legjislacionit kombëtar të Shtetit kontraktues, disa nga këto mënyra janë si më poshtë:

- mbrojtja e dhënies së të drejtës së autorit ose të një të drejte tjetër specifike;
- mbrojtja nëpërmjet ligjit kundrejt një konkurrence jo të drejtë;
- mbrojtja nëpërmjet sanksioneve penale.

Neni 4

Kohëzgjatja e dhënies së mbrojtjes i nënshtrohet legjislacionit kombëtar të çdo shteti kontraktues. Gjithsesi, nëse ligji kombëtar parashikon një kohëzgjatje specifike për mbrojtjen, kjo kohëzgjatje nuk duhet të jetë më pak se 20 vjet, duke u nisur ose nga fundi i vitit gjatë të cilit tingujt e futur në fonograme janë fiksuar për herë të parë, ose të vitit gjatë të cilit fonogramet janë publikuar për herë të parë.

Neni 5

Në rast se një shtet kontraktues kërkon, sipas legjislacionit kombëtar, përmbushjen e formaliteteve lidhur me mbrojtjen e prodhuesve të fonogrameve, kërkesat e tij do të konsiderohen si të përmbushura nëse:

- të gjitha kopjet e autorizuara të fonogrameve që janë shpërndarë në publik ku këllëfi i mbajtësve përmban shenjën e shprehur me simbolin (P) të shoqëruar me treguesin e vitit të parë të publikimit, të vëna në mënyrë të qartë që mbrojtja është ruajtur (rezervuar);
- kopjet ku këllëfi i tyre nuk të lejon të identifikosh prodhuesin, personin që ka të drejtën ose zotëruesin e të drejtës (nëpërmjet një emri, marke ose çdo lloj shenje tjetër dalluese), shënon gjithashtu emrin e prodhuesit, që ka të drejtën, ose të zotëruesit (mbajtësit) të ekskluzivitetit të licencës.

Neni 6

Çdo shtet kontraktues, që siguron mbrojtjen, nëpërmjet mënyrave të cituara në nenin 3, mund që në legjislacionin e tij kombëtar, të krijojë limite në mbrojtjen e prodhuesve të fonogrameve, të të njëjtës natyrë si të atyre të pranuara në fushën e mbrojtjes së autorëve të veprave letrare e artistike. Gjithsesi, asnjë licencë e detyrueshme nuk mund të parashikohet vetëm në rast se plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) riprodhimi i destinohet përdorimit ekskluziv të arsimit, ose të kërkimeve shkencore;

b) licenca vlen për riprodhim vetëm në territoret e shteteve kontraktuese ku autoriteti kompetent ka akorduar licencën dhe nuk mund të shtrihet për eksportim të kopjeve.

c) riprodhimi i bërë nën ndikimin e licencës jep të drejtën e një pagese të drejtë që, fiksohet nga autoritetet, duke pasur parasysh midis të tjerë elementësh, numrin e kopjeve që do të realizohen.

Neni 7

1. Marrëveshja në fjalë, nuk duhet në asnjë mënyrë, të interpretohet si kujdes i mbrojtjes së autorëve, artistëve interpretues, prodhuesve të fonogrameve, ose të organizmave të radiodifuzionit, në bazë të ligjeve kombëtare ose të konventave ndërkombëtare.

2. Legjislacioni kombëtar i çdo shteti kontraktues do të përcaktojë, në rastin e duhur, zgjatjen e kohës mbrojtëse të artistëve interpretues, ekzekutimi i të cilëve është fiksuar në një fonogram, si dhe kushtet në të cilat ata kanë një mbrojtje të tillë.

3. Asnjë shtet kontraktues nuk detyrohet të aplikojë dispozitat e marrëveshjes në fjalë, përsa i përket fonogrameve të përcaktuara, para se këto të hyjnë në fuqi përsa i përket shtetit të përcaktuar.

4. Çdo shtet, legjislacioni kombëtar në fuqi i të cilit, më 29 tetor 1971 ju siguron, prodhuesve të fonogrameve një mbrojtje hartuar vetëm në funksion të vendit të fiksimit të parë mund, që nëpërmjet një njoftimi të depozituar pranë Drejtorit të Përgjithshëm të OMPI-së, të deklarojë që do të aplikojë këtë kriter në vend të atij të kombësisë së prodhuesit.

Neni 8

1. Zyra ndërkombëtare e OMPI-së mbledh e publikon informacione lidhur me mbrojtjen e fonogrameve. Çdo shtet kontraktues komunikon, sa është e mundur, në zyrën ndërkombëtare tekstet e çdo lloj ligji të ri që lidhet me këtë problem.

2. Zyra ndërkombëtare i jep çdo shteti kontraktues, në bazë të kërkesës së saj, këshilla lidhur me Marrëveshjen në fjalë. Ajo procedon gjithashtu, nëpërmjet studimeve dhe duke kryer shërbime të destinuara për lehtësimin e mbrojtjes së parashikuar në këtë Marrëveshje.

3. Zyra ndërkombëtare në bashkëpunim me Organizatën e Shteteve të Bashkuara për edukimin, shkencën e kulturën dhe Organizatën Ndërkombëtare të Punës ushtron funksionet të paraqitura sa më sipër në kryeradhën 1. dhe 2., për probleme të ngritura nga kompetencat e tyre respektive.

Neni 9

1. Marrëveshja në fjalë është depozituar pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Ajo qëndron e hapur deri më 30 prill 1972, me nënshkrimin e të gjithë shteteve anëtare të OKB-së, të një ndër instituteve të specializuara të lidhur me OKB-në ose të Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike ose pjesë e Statutit të Gjykatës së Drejtësisë Ndërkombëtare.

2. Marrëveshja në fjalë i nënshtrohet ratifikimit ose pranimit të Shteteve nënshkruese. Ajo mbetet e hapur deri në miratimin nga institucionet e parashtruara në pikën 1 të këtij neni.

3. Instrumentet e ratifikimit ose të pranimit depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së.

4. Është e kuptueshme se, që nga momenti kur një shtet nënshkruan këtë Marrëveshje, duhet të jetë në gjendje, konform legjislacionit të tij të brendshëm, t'i japë jetë dispozitave të Marrëveshjes.

Neni 10

Asnjë rezervë nuk pranohet në Marrëveshjen në fjalë.

Neni 11

1. Marrëveshja hyn në fuqi tre muaj pas depozitimit të instrumentit të pestë të ratifikimit, pranimit ose të miratimit.

2. Përsa i përket çdo shteti ratifikues që pranon Marrëveshjen në fjalë ose që aderon pas depozitimit të instrumentit të pestë të ratifikimit, të pranimit apo aderimit, Marrëveshja në fjalë hyn në fuqi tre muaj pas datës që, Drejtori i Përgjithshëm i Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale informon shtetet sipas nenit 13 pika 4 të depozitimit të instrumentit të tij.

3. Në momentin e ratifikimit, të pranimit, të aderimit ose në çdo moment të mëvonshëm, çdo shtet mund të njoftojë (deklarojë) me shkrim Sekretarin e Përgjithshëm të OKB-së, që Marrëveshja në fjalë është e aplikueshme në të gjitha ose në ndonjë nga territoret me të cilat ai ka marrëdhënie ndërkombëtare. Ky njoftim hyn në fuqi tre muaj pas datës së marrjes së tij (këtij njoftimi).

4. Gjithsesi, sa u citua më lart, nuk duhet në asnjë rast të interpretohet si implikim i njohjes apo i pranimit të heshtur, i ndonjë nga shteteve kontraktuese, i faktit që të gjithë territoret ku Marrëveshja në fjalë ka hyrë në fuqi nga një shtet tjetër kontraktues për arsye të pikës së tretë.

Neni 12

1. Çdo shtet kontraktues ka të drejtë të prishë Marrëveshjen në fjalë, si në emër të saj, ashtu edhe në emër të një ose të gjithë territoreve të përcaktuara në nenin 11 pika 3. Ky njoftim me shkrim i paraqitet Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së.

2. Prishja e Marrëveshjes hyn në fuqi 12 muaj pas datës së cilës Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së ka marrë njoftim.

Neni 13

1. Marrëveshja në fjalë nënshkruhet, në një kopje në gjuhët anglisht, spanjisht, frëngjisht e rusisht, ku të katër tekstet janë identikisht të barabartë.

2. Tekste zyrtare për gjuhët gjermanisht, arabisht, italisht, nerlandisht e portugalisht, hartohen nga Drejtori i Përgjithshëm i Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale, pas konsultimesh të bëra me Qeveritë e interesuara.

3. Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së njofton Drejtorin e Përgjithshëm të Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale, Drejtorin e Përgjithshëm të OKB-së për edukimin, shkencën e kulturën dhe Drejtorin e Përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës për:

a) nënshkrimet e Marrëveshjes në fjalë;

b) depozitimin e instrumenteve të ratifikimit, pranimit ose aderimit;

c) datën e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes në fjalë;

d) çdo njoftim me shkrim lidhur me nenin 11 pika 3;

e) marrjen e njoftimeve lidhur me prishjen e Marrëveshjes.

4. Drejtori i Përgjithshëm i OMPI-së informon shtetet e përcaktuara në nenin 9 pika 1) mbi të rejat lidhur me aplikimin e pikës së mëparshme, si dhe deklarimet e bëra për nenin 7, pika 4). Ai njofton gjithashtu për deklarimet e bëra Drejtorin e Përgjithshëm të OKB-së për Edukimin, Shkencën e Kulturën, si dhe Drejtorin e Përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës.

5. Sekretari i Përgjithshëm i OKB i dërgon dy kopje të vërtetuara konform Marrëveshjes në fjalë, shteteve të parashikuara (kërkuara) në nenin 9 pika 1.

LIGJ
Nr.8586, datë 15.3.2000

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË GARANCISË NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (BERZH), NË KUADRIN E MARRËVESHJES SË HUASË, NDËRMJET KESH-IT DHE BERZH-IT PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT "RINDËRTIMI I SEKTORIT TË ENERGJISË"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja e garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), në kuadrin e marrëveshjes së huasë, ndërmjet KESH-it dhe BERZH-it për financimin e projektit "Rindërtimi i sektorit të energjisë"".

Neni 2

Ligji nr.7902, datë 15.2.1995 "Për ratifikimin e marrëveshjes së garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim e Zhvillim, në kuadrin e marrëveshjes së Kredisë ndërmjet Korporatës Elektroenergjetike shqiptare dhe Bankës Europiane për Rindërtim e Zhvillim" dhe ligjin nr.8059, datë 8.2.1996 "Për ratifikimin e "Marrëveshjes së garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin e Transmetimit dhe Shpërndarjes së Energjisë Elektrike", shfuqizohen në çastin e lëvrimit të pagesës sipas nenit 2 të "Marrëveshjes së Huasë ndërmjet Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim për financimin e projektit "Rindërtimi i Sektorit të Energjisë"".

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2578, datë 27.3.2000, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

MARRËVESHJE GARANCIE

(Projekti i rindërtimit të sektorit të energjisë)

midis Republikës së Shqipërisë (Garantuesi) dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka)

(datë 8 dhjetor 1999)

HYRJE

Ndërsa, Garantuesi dhe KESH (Huamarrësi) kanë kërkuar asistencë nga Banka për financimin e një pjese të projektit;

Ndërsa, sipas Marrëveshjes së Huasë të kësaj date midis Huamarrësit dhe Bankës ("Marrëveshja e Huasë" siç përcaktohet në Termat dhe Kushtet Standarde), Banka ka rënë dakord t'i japë Huamarrësit një Hua deri në shumën 30 milionë Euro sipas kushteve dhe termave të Marrëveshjes së Huasë, por vetëm me kusht që Garantuesi të garantojë detyrimet e Huamarrësit siç përcaktohet në Marrëveshjen e Garancisë; dhe

Ndërsa, Garantuesi ka rënë dakord të garantojë këto detyrime të Huamarrësit duke marrë parasysh që Huamarrësi dhe Banka ka lidhur një Marrëveshje Huaje.

Për këtë arsye palët bien dakord si më poshtë:

Neni 1
Termat standarde dhe kushtet. Përcaktime

Seksioni 1.01. Përfshirja e termave dhe kushteve standarde

Të gjitha dispozitat e Termave dhe Kushteve Standarde të datës shkurt 1999 përfshihen dhe janë të aplikueshme për këtë Marrëveshje Garancie me të njëjtën fuqi si të ishin të shkruara këto.

Seksioni 1.02. Përcaktime

Kudo që përdoret në këtë Marrëveshje Garancie (përfshirë Hyrjen), përveç kur pohohet ndryshe ose e kërkon konteksti, termat e dhëna në Hyrje kanë kuptimin e dhënë aty dhe termat e përcaktuara në kushtet dhe termat standarde dhe në Marrëveshjen e Huasë kanë kuptimet respektive të dhëna aty, ndërsa termi i mëposhtëm do të ketë kuptimin:

"Përfaqësuesi i Autorizuar i Garantuesit" nënkupton ministrin e Financave të Garantuesit.

Seksioni 1.03. Interpretimi

Në këtë Marrëveshje Garancie, referencat për një nen ose seksion të caktuar, përveç kur parashikohet ndryshe në Marrëveshjen e Garancisë, do të merren si referenca për atë nen ose seksion specifik të kësaj Marrëveshjeje Garancie.

Neni II
Garancia dhe Detyrime të tjera

Seksioni 2.01. Garancia

Garantuesi garanton pa kushte, si debitor primar pagesën në kohë të ndonjë shume të detyruar sipas Marrëveshjes së Huasë ose në kohën e maturimit ose shpejtimit ose ndryshe, dhe shlyerjen e përpiktë të të gjithë detyrimeve të Huamarrësit siç janë përcaktuar në Marrëveshjen e Huasë.

Seksioni 2.02. Përfundimi i Projektit

(a) Kur ka shkak të arsyeshëm për të besuar se fondet në dispozicion të Huamarrësit nuk janë të

mjaftueshme për të kryer shpenzimet e parashikuara për kryerjen e projektit, Garantuesi do të marrë masa për t'i siguruar këto fonde siç nevojitet.

(b) Garantuesi do të verë në dispozicion të Huamarrësit fonde sipas marrëveshjeve të bashkëfinancimit në të cilat ai është palë. Nëse e drejta e Garantuesit për të tërhequr fonde në ndonjë nga marrëveshjet e bashkëfinancimit është pezulluar, fshirë ose ka mbaruar pjesërisht ose tërësisht, Garantuesi merr përsipër të gjejë fondet e mjaftueshme për përfundimin e projektit.

(c) Pa kufizuar përgjithësinë e ndonjë dispozite tjetër të kësaj marrëveshje garancie ose Kushteve dhe Termave Standarde, Garantuesi do të përdorë të gjitha mjetet për të bërë që Huamarrësi të lejohet, në përputhje me ligjin shqiptar, të implementojë rregullime në nivel dhe strukturën e tarifave të energjisë së Huamarrësit, në mënyrë që të sigurojë që Huamarrësi të jetë në gjendje të përmbushë detyrimet e tij sipas Marrëveshjes së Huasë.

Seksioni 2.03. Detyrime të tjera

(a) Garantuesi nuk do të vendosë ndonjë taksë direkte ose indirekte mbi konsulentët e huaj që do të punësohen nga Huamarrësi ose Banka për implementimin e projektit dhe të financuar nga Huaja.

(b) Garantuesi do të përdorë të gjitha mjetet për të siguruar që ndërmarrjet buxhetore dhe ato shtetërore të bëjnë pagesa për Huamarrësin për energjinë e shpenzuar.

(c) Përveç kur banka bie dakord ndryshe, Garantuesi do të bëjë të gjitha përpjekjet për të siguruar që Programi i Asistencës në Menaxhim të implementohet në përputhje me termat dhe kushtet e pranueshme nga Banka.

(d) Garantuesi do t'i japë Huamarrësit të drejtën për të fshirë faturat e pambledhshme të energjisë.

(e) Garantuesi do t'i sigurojë, kur kërkohet, të gjitha licencat, miratimet ose pëlqimet e kërkuara nga Huamarrësi për financimin e përfundimin e projektit dhe për të kryer biznesin duke përfshirë të gjitha licencat dhe miratimet e nevojshme për të siguruar që Huamarrësit t'i jepet e drejta e kalimit dhe përdorimit të ndonjë toke për ndërtimin e linjave të transmetimit të përshkruara në Pjesën B.

(f) Garantuesi do t'i ngarkojë Huamarrësit një komision 0.5% në vit të llogaritur mbi shumën e patërhequr të huasë, duke përfshirë principal, interes dhe detyrimet e tjera mbi to.

Neni III
Të ndryshme

Seksioni 3.01. Lajmërimet

Adresat e mëposhtme specifikohen për qëllime të seksionit 10.01 të termave dhe kushteve standarde:

Për garantuesin:	**Për Bankën:**
Ministri i Financave të RSH	EBRD
Ministria e Financave	One Exchage Sq.
Bulevardi Dëshmorët e Kombit	London, UK
Tiranë	
Attn: Drejtorisë së Borxhit	Attn: Njësia e administrimit të operacioneve
Fax: 42 284 94	Fax: 44 20 733 8 6100

Seksioni 3.02. Opinioni ligjor

Për qëllime të Seksionit 9.03 të Termave dhe Kushteve Standarde në përputhje me Seksionin 6.02 të Marrëveshjes së Huasë, do të jepet një opinion ligjor në emër të Garantuesit nga ministri i Drejtësisë.

Palët, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar, nënshkruajnë këtë marrëveshje garancie në 4 kopje secila origjinale në anglisht në ditën e dhënë më sipër.

RSH Anastas Angjeli – Ministër i Financave

BERZH Charles R.Frank.

IR – Zv/Presidenti i Parë

MARRËVESHJA E HUASË

(Projekt i Rindërtimit të Sektorit të Energjisë) ndërmjet Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare (ose Huamarrësi) dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka), me garanci të Republikës së Shqipërisë, datë 8 dhjetor 1999)

Marrëveshje, datë 8 dhjetor 1999 ndërmjet Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare (ose Huamarrësi) dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim

Parathënie

Ndërsa, Banka ka vendosur të sigurojë financimin e projekteve të veçanta për të ndihmuar tranzicionin drejt ekonomisë së tregut të lirë dhe të përkrahë iniciativën private dhe ndërmarrëse në vendet e Europës Qendrore dhe Lindore të angazhuara të zbatojnë demokracinë shumëpartiake, pluralizmin dhe ekonominë e tregut.

Ndërsa, Huamarrësi është në pronësi tërësisht shtetërore, e organizuar sipas ligjit tregtar shtetëror nr.7638, datë 19 nëntor 1992, me qëllim prodhimin, transmetimin, shpërndarjen dhe shitjen e energjisë dhe avullit në Shqipëri.

Ndërsa, Huamarrësi ka qëllim të realizojë Projektin e përshkruar në Schedule 1, për të zhvilluar sistemin e transmetimit dhe të shpërndarjes së energjisë së Huamarrësit me objektiva përmirësimin e eficencës së energjisë nëpërmjet uljes së humbjeve teknike dhe vjedhjes së energjisë nëpërmjet përmirësimit të matjeve.

Ndërsa, Republika e Shqipërisë (Garanti) dhe Huamarrësi kanë kërkuar asistencë nga Banka për të financuar pjesë të Projektit.

Ndërsa, Huamarrësi ka kontaktuar me Bankën Japoneze për kooperim Ndërkombëtar (JBIC) një hua në shumën 1 681 000 000 për të ndihmuar financimin e pjesëve A-1-b dhe A-2-b të Projektit sipas temave dhe kushteve të diskutuara ndërmjet Huamarrësit dhe "JBIC" (Marrëveshja e huasë me "JBIC").

Ndërsa, Qeveria e Republikës së Austrisë i ka mundësuar Republikës së Shqipërisë një kontribut në formë granti në shumën prej 84 500 000 Shilinga Austriake për të ndihmuar financimin e pjesës A-2-a të Projektit sipas termave dhe kushteve të një marrëveshjeje të diskutuar ndërmjet Huamarrësit dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë (Marrëveshja e Grantit të Qeverisë Austriake).

Ndërsa, Konfederata Zvicerane i ka mundësuar Republikës së Shqipërisë një kontribut në formë granti në shumën prej 10 500 000 Sfr (Franga Zvicerane) për të ndihmuar në financimin e Pjesës A-1-a të Projektit sipas termave dhe kushteve të një marrëveshje të diskutuar ndërmjet Huamarrësit dhe Konfederatës Zvicerane (Marrëveshja e Grantit të Qeverisë Zvicerane)

Ndërsa, më 22 nëntor 1994, Banka ka hyrë në një Marrëveshje huaje me Huamarrësin për të siguruar një hua prej 23 760 000 DM për të ndihmuar Huamarrësin në financimin e rehabilitimit të Hidrocentraleve përgjatë lumit Drin (sipas amendamentit të 12 tetor 1995 dhe 5 dhjetor 1995, Marrëveshje e Huasë së lumit Drin).

Ndërsa, më 12 dhjetor 1995, Banka ka hyrë në një Marrëveshje huaje me Huamarrësin për të siguruar një hua 10 000 000 ECU për të ndihmuar Huamarrësin për të financuar në modernizimin e Sistemit të vet Kombëtar të transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë (Marrëveshja e Huasë së Projektit të Transmetim-Shpërndarjes).

Ndërsa, Banka dhe Huamarrësi kanë rënë dakord ta anulojnë Marrëveshjen e Huasë së Lumit Drin dhe Marrëveshjen e Huasë së PTS.

Ndërsa, Huamarrësi ka kërkuar të lejohet financimi i kostove të marrëveshjes së mëparshme, sipas

Marrëveshjes së Huasë së lumit Drin ("Drin River Unwnding Costos) nga shumat e huasë së re që shtohen sipas kësaj Marrëveshjeje dhe që për të cilat Banka ka rënë dakord.

Ndërsa, sipas Marrëveshjes së Garancisë në këtë datë këtu, ndërmjet Garantit dhe Bankës ("Marrëveshje e Garancisë", siç përcaktohet në temat dhe kushtet standarde). Garanti ka garantuar detyrimet e Huamarrësit sipas Marrëveshjes.

Ndërsa, Banka ka rënë dakord ndërmjet të tjerave, të lartpërmendura, të ofrojë një hua për Huamarrësin në vlerën 30 000 000 EUR, sipas kushteve dhe termave të pranuara në këtë Marrëveshje.

Prandaj, palët bien dakord si më poshtë:

Neni 1
Termat dhe kushtet standarde. Përkufizimet

SEKSIONI 1.01. PËRFSHIRJA E TERMAVE DHE KUSHTEVE STANDARDE

Termat dhe Kushtet Standarde, të gjitha klauzolat, kushtet dhe Termat Standarde të Bankës, datë, shkurt 1999, janë përfshirë këtu dhe bëhen të aplikueshme për këtë Marrëveshje Huaje me të njëjtën forcë dhe efekt dhe në këtë kontratë; megjithëse subjekt i modifikimeve ato përbëjnë "Termat dhe Kushtet Standarde"

(a) Seksionet 3.05 (b) në Termat dhe Kushtet Standarde të Bankës datë shkurt 1999, nuk do të aplikohen në këtë marrëveshje.

SEKSIONI 1.02. PËRKUFIZIMET

Sa herë që përdoren në këtë Marrëveshje (përfshirë Parathënia dhe Schedule) përveç se kur konteksti e kërkon ndryshe, termat e përcaktuara në parathënie kanë kuptimet, respektive si në klauzolat e përcaktuara në Termat dhe Kushtet Standarde me kuptimet respektive; termat e mëposhtme kanë kuptimet respektive si në klauzolat e përcaktuara në Termat dhe Kushtet Standarde me kuptimet respektive; termat e mëposhtme kanë kuptimet, si më poshtë:

"Autoriteti Përfaqësues i Huamarrësit" është Drejtori i Përgjithshëm i Huamarrësit

"Bashkëfinancierët" janë Qeveria e Republikës së Austrisë, Qeveria e Konfederatës Zvicerane dhe Banka Japoneze për Kooperim Ndërkombëtar.

"Marrëveshjet e Bashkëfinancimit" – janë Marrëveshja e Grantit me Qeverinë Austriake, Marrëveshja e Grantit me Qeverinë Zvicerane, Marrëveshja e Huasë me JBIC.

"Borxhi" për Huamarrësin, të gjitha detyrimet që ka Huamarrësi brenda një viti pas datës fillestare, dhe kur shfaqen si principale ose garanci për tani, të ardhmen, aktuale ose kontingjent për pagesë ose ripagesë të parave, ku përfshihen pa kufizim;

a) Çdo shumë e pagueshme nga ana e Huamarrësit për qiratë ose të ngjashme për periudhat e tyre respektive.

b) Çdo kredi e dhënë Huamarrësit nga një furnitor mallrash ose për çdo këst blerje ose të tjera të ngjashme; dhe

c) Çdo vleftë dhe detyrim e palëve të treta në atë masë që garantohet nga Huamarrësi ose për të cilat Huamarrësi beson që duhet të paguhen në atë masë që të sigurohen nga ata që kanë të drejtën e pasurisë së Huamarrësit dhe nëse e di ose jo që duhet të paguaj për këto shuma apo detyrime.

"Shuma e shërbimit të Debitit" – është interesi i veçantë që mbart shumën e depozitës, sipas seksionit 3.08 (b).

"Shuma Rezervë e Shërbimit të Debitit" – është, që në çdo kohë, një shumë e barabartë me 1.25 herë shumën e principalit, interesit dhe shumat e tjera të parashikuara të pagueshme për Bankën për gjashtë muajt e tjerë.

"Humbjet në Shpërndarje" – janë, në çdo kohë humbjet e energjisë të shprehura si përqindje e energjisë së përgjithshme në energjetikën shqiptare dhe e përcaktuar sipas formulës së mëposhtme:

(S – D)/S

S = Sasia e përgjithshme e energjisë së furnizuar në rrjetin energjetik shqiptar nga prodhimi i brendshëm dhe importet e energjisë minus shumën e çdo energjie të eksportuar nga Republika e Shqipërisë.

D = Sasia e energjisë aktualisht e faturuar deri në konsumatorin e fundit.

"Plani i Veprimeve për ambientin" – është plani i Projektit sipas Seksionit 3.01(d) dhe ky plan mund të ndryshojë nga koha në kohë paraprakisht i miratuar me shërbim nga Banka.

"Viti fiskal" – është viti fiskal i Huamarrësit që fillon më 1 janar të çdo viti.

"Objektivi i Zbatimit" – është objektivi i zbatimit sipas Seksionit 3.01(b) dhe që i bashkëngjitet Schedule 3, lidhur me uljen e Humbjeve të Shpërndarjes.

"Data e pagesës së Interesit" – është Dita e Biznesit e përzgjedhur nga Huamarrësi si e tillë sipas Seksionit 2.02 (h),(2)(B) të kësaj Marrëveshjeje.

"Supervizori i Huadhënësit" – është konsulenti ose konsulentët përzgjedhur nga koha në kohë nga Banka për monitorimin e zbatimit tërësor fizik të projektit në emër të Bankës.

"Llogaria Lokale e Projektit" – është interesi i veçantë që mbart shumën e depozituar sipas Seksionit 3.08(a).

"Programi i Asistencës Menaxhimit" – është programi i asistencës së menaxhimit sipas Seksionit 3.07.

"Raportet Periodike" – janë raportet periodike sipas Seksionit 3.06(c).

"PMU" – është njësia e menaxhimit të projektit sipas seksionit 3.02.

"Llogaritë e Projektit" – është llogaria lokale e projektit dhe Llogaria e Shërbimit të Debitit.

"Fleta e Referencës" – është Display Page e Herbank Londer të përqindjeve të ofruara të Bankave më të mëdhaja për depozitimin e Monedhës për Huanë, e përshkruar sipas faqes 3750 në Telerate Service, për qëllim të paraqitjes së përqindjeve të afruara në depozitat në monedhën e Huasë.

"Statut" është dokumenti bazë i organizimit të Huamarrësit, përfshirë Aktin e Themelimit të 17 Tetorit 1995 urdhrin e Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë Nr.74 të 2 Nëntorit 1995 dhe vendimi i Gjykatës së Tiranës nr.12728 të 6 nëntorit 1995.

SEKSIONI 1.03. INTERPRETIMI

Në këtë Marrëveshje, referenca për një nen të veçantë, Seksion apo Schedule interpretohet si referencë e nenit seksionit ose schedulit të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 2

Termat kryesore të Huasë

SEKSIONI 2.1. SHUMA DHE MONEDHA

Banka është dakord t'i japë Huamarrësit, bazuar në termat dhe kushtet e përcaktuara sipas kontratës një shumë prej 30.000.000 EUR.

SEKSIONI 2.02. TERMA TË TJERA FINANCIARE TË HUASË

a) Shuma minimale e Tërheqjes do të jetë 50 000 EUR.
b) Shuma minimale e paraqitjes do të jetë 3 000 000 EUR.
c) Shuma minimale e anuluar do të jetë 2 000 000 EUR.
d) Datat e pagesës së interesit do të jenë 25 maj dhe 25 nëntor i çdo viti.
e) Huamarrësi do të paguajë principalin e Huasë në datat e mëposhtme dhe sipas shumave.

Tabela

Data e Ripagesës së Huasë	Shuma Principale
25 maj 2002	EUR 1,500,000
25 nëntor 2002	EUR 1,500,000
25 maj 2003	EUR 1,500,000
25 nëntor 2003	EUR 1,500,000
25 maj 2004	EUR 1,500,000
25 nëntor 2004	EUR 1,500,000
25 maj 2005	EUR 1,500,000
25 nëntor 2005	EUR 1,500,000
25 maj 2006	EUR 1,500,000
25 nëntor 2006	EUR 1,500,000
25 maj 2007	EUR 1,500,000
25 nëntor 2007	EUR 1,500,000
25 maj 2008	EUR 1,500,000
25 nëntor 2008	EUR 1,500,000
25 maj 2009	EUR 1,500,000
25 nëntor 2009	EUR 1,500,000
25 maj 2010	EUR 1,500,000
25 nëntor 2010	EUR 1,500,000
25 maj 2011	EUR 1,500,000
25 nëntor 2011	EUR 1,500,000
Totali	**EUR 30, 000, 000**

f) Data e fundit e Vlefshmërisë do të jetë 30 prill 2002.

g) Përqindja e Përmbushjes së Detyrimit do të jetë 0,5% në vit.

h) Përqindja e interesit.

1) Huaja është subjekt i një interesi variabël, për qëllimet e Seksionit 3.04(b) të Termave dhe Kushteve Standarde, interesi i tregut do të jetë interesi në vit për depozitat në Monedhën e Huasë që jepet në Referencë Page ora 11 sipas orës së Londrës, sipas interesit fiks të periudhës më të afërt që vazhdon interesi (ose nëse dy periudhat janë të përafërta me kohën kur interesi vazhdon, merret interesi i tyre) me kusht që:

A) Nëse për ndonjë arsye, Interesi i Tregut nuk mund të përcaktohet në këtë kohë nga referenca në referencë page, interesi i tregut do të jetë përqindja që Banka vendos të jetë në kuptimin aritmetik (e rrumbullakosur, nëse është e nevojshme me përafërsisht 1/16%) të përqindjeve në vit për depozitat në Monedhën e Huasë me një shumë të krahasueshme me pjesën e Huasë të planifikuar për të mos u paguar gjatë periudhës së interesit për një kohë të barabartë me këtë periudhë interesi që i këshillohen Bankës nga tri Banka të mëdha aktive në tregun ndërbankar të Londrës, të zgjedhur nga Banka.

B) Nëse Banka vendos që depozita në Monedhën e Huasë, të mos ofrohen në tregun ndërbankar të Londrës, për këto shuma apo këtë periudhë, përqindja e interesit do të jetë kosto në Bankë (e shprehur si përqindje në vit) e fondit të pjesës së Huasë së planifikuar për t'u mos paguar gjatë periudhës së Interesit nga çfarëdo burimi të zgjedhur nga Banka.

2) Kur nuk përmbahemi për sa më sipër, Huamarrësi mund të zgjedhë të paguajë Interesin në një përqindje të fiksuar interesi për këtë pjesë të huasë, si altenativë për të paguar interesin, me Përqindjen e Interesit Variabël për të gjithë apo pjesë të Huasë së papaguar, si më poshtë:

a) Huamarrësi mund ta ushtrimojë këtë obsion nëse:

i) Në kohën e ushtrimit nuk ka asnjë ndodhi, ose nuk vazhdon të ketë, nga ato që specifikohen në Seksionin 7.01 të Termave dhe Kushteve Standarde (dhe asnjë ndodhi që mund të shfaqet si e tillë ose të kthehet si e tillë)

ii) Shuma principale e Huasë kur konvertohet nga një Përqindje Interesit Variabël në një përqindje të Interesit Fiks, të mos jetë më pak se 5 000 000 EUR.

b) Huamarrësi do të ushtrimojë këtë variant duke njoftuar Bankën në jo më pak se 5 ditë Biznesi para datës së interesit të Fiksuar të propozuar. Ky njoftim do të jetë i parevokueshëm, përveç se kur Banka s'është dakord, dhe do të specifikojë datën e interesit të fiksuar dhe datën e interesit të ndryshuar të përzgjedhur nga Huamarrësi dhe shuma e principalit të huasë të ndryshojë në një përqindje të interesit fiks.

c) Duke filluar në datën e konvertimit të interesit, masa e huasë për t'u konvertuar (sipas specifikimit në njoftimin e Huamarrësit) do të jetë subjekt për përqindjen e interesit të fiksuar. Për qëllime të seksionit 3.4(a) të termave dhe kushteve standarde, përqindja e interesit përkatës të tregut, do të jetë përqindja e interesit të fiksuar të paraqitur për monedhën e huasë që mundësohet nga Banka në treg në këtë datë të fiksimit të interesit për periudhën që fillon në datën e interesit të konvertuar dhe që përfundon në datën përfundimtare të ripagesës së huasë, duke pasur në konsideratë ripagesën e principalit dhe schedule të pagesës së interesit për huanë. Banka do të përcaktojë përqindjen e interesit të fiksuar në këtë datë dhe menjëherë njofton për këtë huamarrësin dhe garantin.

d) Banka ndonjëherë mund të mendojë për të konsoliduar të gjitha përqindjet e interesit të fiksuar në mesataren e përqindjeve të interesit të fiksuar të zbatueshme për pjesë të huasë. Banka do të përcaktojë këtë përqindje të Interesit të Fiksuar dhe do të njoftojë direkt Huamarrësin për to. Këto përqindje të konsoliduara të interesit të fiksuar do të zbatohen për të gjitha pjesët e huasë që kanë mbartur interes me përqindjet e interesit të fiksuar duke filluar nga data e pagesës së interesit pas njoftimit që banka i bën Huamarrësit.

SEKSIONI 2.03. TËRHEQJET

a) Shuma e vlefshme mund të tërhiqet herë pas here sipas klauzolave të schedule 2 për financim, si:

1) shpenzimet e bëra (ose që duhen bërë, nëse është dakord Banka), për kosto të arsyeshme mallrash, punimesh dhe shërbimesh që kërkohen nga Projekti.

2) për interesin gjatë ndërtimit.

b) Huamarrësi, përsa thuhet, autorizon Bankën për të tërhequr nga shuma e vlefshme një shumë të barabartë me kostot e marrëveshjes së mëparshme të lumit Drin dhe i paguan këto kosto në emër të Huamarrësit.

Neni 3
Ekzekutimi i projektit

SEKSIONI 3.01. MARRËVESHJE TË TJERA POZITIVE TË PROJEKTIT

Në vazhdim të marrëveshjeve të vendosura më përpara në nenin 4 të kushteve dhe termave standarde, huamarrësi, me miratim të bankës, duhet:

a) të ndërmarrë veprimet e duhura për të plotësuar me fondet e nevojshme Projektin.

b) të ulë humbjet e shpërndarjes për çdo vit në mënyrë të tillë që humbjet e shpërndarjes të mos kalojnë objektivin e zbatimit për atë vit sipas schedule 3.

c) të dorëzojë planin e veprimtarisë së mjedisit në formë dhe përmbajtje sipas kërkesave të Bankës para 31 dhjetorit 2000.

d) të rimbursojë bankën për të gjitha kostot e zotuara nga Banka lidhur me supervizorin e Huadhënësit.

e) të plotësojë të gjitha detyrimet sipas të gjitha marrëveshjeve bashkëfinanciare ku merr pjesë si palë.

f) të plotësojë të gjitha kushtet dhe termat për çdo marrëveshje e të tjera ku bën pjesë si palë.

SEKSIONI 3.02. NJËSIA E MENAXHIMIT TË PROJEKTIT

Për të koordinuar, menaxhuar, monitoruar dhe vlerësuar të gjitha aspektet e menaxhimit dhe zbatimit të Projektit, Huamarrësi me miratim të Bankës, do të krijojë dhe operojë me njësi të menaxhimit të projektit, gjatë gjithë kohës së ekzekutimit të Projektit, që ka burimet e nevojshme dhe personel të kualifikuar sipas termave të referencës të pranueshme për Bankën.

SEKSIONI 3.03. PROKURIMI

Për qëllimet e seksionit 4.03 të kushteve dhe termave standarde klauzolat e mëposhtme ndryshe nëse Banka nuk i miraton do të udhëheqin prokurimin e mallrave, punimet dhe shërbimet e kërkuara për projektin dhe që duhen financuar nga shumat e huasë.

a) Mallrat, punimet dhe shërbimet (jo shërbimet e konsulentëve të përfshira në Seksionin 3.03(c), do të prokurohen nëpërmjet tenderit të hapur.

b) Për qëllimet e Seksionit 3.03(a) procedurat për tenderin e hapur janë përcaktuar në kapitullin 3 të Rregullave të Prokurimit të EBRD.

c) Konsulentët që punësohen nga Huamarrësi për të ndihmuar në zbatimin e Projektit, përzgjidhen sipas procedurave në kapitullin 5 të rregullave të Prokurimit të EBRD.

d) Të gjitha kontratat do të jenë subjekt për procedurat e shqyrtuara në shtojcën 1 të rregullave të prokurimit të EBRD. Kontratat e mëposhtme janë subjekt i rishqyrtimit paraprak.

1) Kontratat e mallrave, punimeve dhe shërbimeve (jo shërbimet e konsulentëve që vlerësohen me një kosto të barabartë me 200.000 ose më shumë EUR, dhe

2) Kontratat për shërbimet e konsulentëve që vlerësohen me një kosto të barabartë me 50.000 EUR ose më shumë.

SEKSIONI 3.04. MARRËVESHJET PËR MJEDISIN

Pa kufizuar të përgjithshmen e seksionit 4.02(a), 4.04(a)(iii) dhe 5.02(c)(iii) të termave dhe kushteve standarde, Huamarrësi, ndryshe nëse banka, nuk e miraton, do të:

a) realizojë projektin sipas standardeve në fuqi për mjedisin, herë pas here, në territorin e Huamarrësit dhe sipas standardeve të Unionit Europian ekzistues në këtë datë (dhe nëse këto standarde të Unionit europian nuk ekzistojnë sipas Word Bank Pollution Prevention dhe Abatement Handbook) dhe

b) pa kufizuar nënseksionin (a) më sipër të zbatojë mirë dhe t'i përmbahet Enviromental Action Plan (Planit Ambiental).

SEKSIONI 3.05. KONSULENTËT

a) Për të ndihmuar në zbatimin dhe menaxhimin e Projektit duke përfshirë asistencën e Njësisë Menaxhimit të Projektit (PMU), Huamarrësi, ndryshe nëse Banka nuk e miraton, do të punësojë ose mundësojë punësimin e, siç kërkohet, dhe të përdorë konsulentë që kanë kualifikim, eksperiencë me terma reference sipas kërkesave të Bankës.

b) Huamarrësi do të sigurojë, pa pagesë, çdo konsulenti të angazhuar në ndihmë të problemeve të Projektit ose veprimtaritë e Huamarrësit (duke përfshirë, për të shmangur dyshime, Supervizorin e Huamarrësit) të gjitha pajisjet e nevojshme për të realizuar funksionet e tyre, përfshirë zyrën, fotokopje, pajisjen, shërbimet sekretariale dhe transportin, si dhe të gjitha dokumentet, materialet dhe informacionin tjetër që ka lidhje me punën.

SEKSIONI 3.06. FREKUENCA E RAPORTIMIT DHE DORËZIMI I KËRKESAVE

a) Huamarrësi do t'i dorëzojë Bankës një raport vjetor mbi çështjet e mjedisit lidhur me projektin sipas seksionit 4.04(a) (iii) të termave dhe kushteve standarde dhe shëndetin e punëtorëve dhe çështje të sigurimit që kanë lidhje me projektin dhe veprimtaritë e Huamarrësit brenda 90 ditëve pas çdo fund viti fiskal. Ky raport do të përfshijë specifikat e mëposhtme:

1) përshkrim i progresit të bërë në zbatimin e planit ambiental;

2) çdo ndryshim në ligjet dhe rregullat e mjedisit, shëndetit dhe sigurimit;

3) çdo incident që nuk përkon me ligjet e zbatueshme dhe rregullat, duke përfshirë çdo veprim të marrë ose të propozuar nga Huamarrësi që i adresohet këtij incidenti.

b) Huamarrësi do të njoftojë direkt për çdo incident material ose aksident që lidhet me Projektin që mund të ketë një efekt të kundërt mbi mjedisin ose shëndetin e punëtorëve dhe sigurimit.

c) Huamarrësi do të dorëzojë raporte periodike për Projektin sipas Seksionit 4.04(a) (iv) të Termave dhe Kushteve Standarde në çdo tremujor, brenda 30 ditëve pas periudhës në fund kur është raportuar, deri sa të përfundojë Projekti. Këto raporte do të përmbajnë specifikat e mëposhtme:

1) Informacionin e përgjithshëm të mëposhtëm:

a) Progresin fizik të bërë në zbatimin e Projektit në datën e raportimit dhe gjatë periudhës së raportimit.

b) Vështirësitë aktuale dhe që mund të priten ose vonesat në zbatimin e projektit dhe efekti i tyre në afatin e zbatimit, dhe hapat aktuale të ndërmarra ose të planifikuara për të kaluar vështirësitë dhe evituar vonesat.

c) Ndryshimet e pritura në datën e përfundimit të projektit, duke përfshirë informacionin në afatet e ndryshuara dhe planin e prokurimeve.

d) Ndryshimet kryesore të personelit për afatin e përfituesve, struktura organizative e PMU përfshirë informacionin mbi stafin lokal dhe të huaj të PMU, konsulentët ose kontaktorët.

e) Çështje që mund të kenë efekt mbi koston e Projektit dhe

f) Çdo zhvillim ose veprimtari që mund të ketë efekt në vlefshmërinë ekonomike të ndonjë Pjese të Projektit.

2) Një tabelë e progresit të Projektit, bazuar në schedule e zbatimit të projektit, ku tregohet progresi për çdo pjesë të projektit dhe përfshihet një grafik i shpenzimeve të planifikuara dhe aktuale për 12 muajt e tjerë.

3) Situacioni financiar ku jepen hollësi të shpenzimeve për çdo pjesë të projektit dhe tërheqjet së bashku me situacionin ku jepen:

A) Vlerësimet fillestare të kostos.

B) Vlerësimet e ndryshuara të kostos, nëse ka, me arsyet për ndryshime.

C) Shpenzimet fillestare të vlerësuara deri në këtë datë.

D) Arsyet për ndryshime të shpenzimeve aktuale nga shpenzimet fillestare të vlerësuara deri në këtë datë, dhe

E) Shpenzimet e vlerësuara për 12 muajt e tjerë.

4) Një situacion përmbledhës i statusit të përshtatjes së çdo nënmarrëveshje të kësaj Marrëveshjeje, ku përfshihet informacioni mbi rezultatet e arritura për arkëtimet sipas shumave për t'u mbledhur.

5) Një situacion i statutit të shumave të projektit.

6) Ndonjë informacion tjetër që mund të kërkohet nga Banka, arsyeshëm.

7) Huamarrësi do t'i japë Bankës një plan financiar për 3 vitet e mëvonshme, që të plotësojë kërkesat e Bankës, ku përfshihet një informacion i hollësishëm për burimet e financimit vjetor të këtyre investimeve, brenda 6 muajve pas çdo fund viti fiskal.

SEKSIONI 3.07. PROGRAMI I ASISTENCËS SË MENAXHIMIT

Përveç se kur Banka është dakord ndryshe, Huamarrësi do të ndërtojë me ose para 30 qershorit 2000 dhe gjatë gjithë kohës pas këtij afati do të mbajë një program të asistencës së menaxhimit

("Management Assistance Programme") sipas termave dhe kushteve të pranueshme për Bankën, nëpërmjet të cilës Huamarrësi do të kontraktojë me një ndërmarrje të huaj private për të mundësuar një grup menaxherësh për kryerjen e detyrave të caktuara, si më poshtë:

a) Ulja e vjedhjes së energjisë;

b) rritja e arkëtimeve për energjinë e faturuar;

c) rishikimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe propozimi për masa të tjera financiare dhe kontabile për të krijuar një sistem raportimi financiar të qëndrueshëm dhe

d) Asistencë për Huamarrësin në përcaktimin dhe zbatimin e investimeve përparësore dhe masa të tjera që lidhen direkt me detyrat sipas nënseksioneve (a) tërësisht (c) më sipër.

SEKSIONI 3.08. LLOGARITË E PROJEKTIT

a) Për qëllime të projektit, Huamarrësi do të hapë dhe mbajë për vazhdimësinë e ndërtimit një depozitë të veçantë në monedhën lokale ("Llogaria Lokale e Projektit") në një Bankë tregtare të pranueshme për Bankën sipas termave dhe kushteve të pranueshme nga Banka duke përfshirë proteksionin e duhur përkundrejt tërheqjeve, përvetësimit, apo përdorimit për diçka tjetër. Gjatë gjithë kohës së ndërtimit dhe për ndonjë ndodhi me ose para datës efektive, Huamarrësi do të mbajë në llogaritë lokale të projektit një bilanc minimal të barabartë me shumën e përdorur nga Huamarrësi për projektin nga burimet e veta për 3 muajt pasardhës si përcaktohet në raportet periodike.

b) Huamarrësi, për qëllime të Projektit, të hapë dhe mbajë deri në plotësimin e çdo detyrimi të Huamarrësit sipas Marrëveshjes, një llogari depozite të veçantë në monedhën e huasë ("Llogaria për shërbim të Debitit") në një bankë tregare të huaj të pranueshme për bankën tonë, sipas termave dhe kushteve të pranueshme për bankën duke përfshirë proteksionin e duhur përkundrejt tërheqjeve, përvetësimit, apo përdorimit për diçka tjetër. Pas daljes efektive, Huamarrësi do të mbajë në Llogarinë e Shërbimit të Debitit një bilanc minimal të barabartë me shumën rezervë të shërbimit të debitit për 30 ditë para çdo date të ripagesës së huasë dhe datës së pagesës së interesit.

Neni 4
Marrëveshjet financiare dhe operacionale

SEKSIONI 4.01. REGJISTRIMET FINANCIARE DHE RAPORTET

a) Huamarrësi do të mbajë procedurat, regjistrimet dhe llogaritë (duke përfshirë ato që lidhen me Llogaritë e Projektit) të duhura për të reflektuar sipas standardeve kontabile ndërkombëtare të pranueshme dhe që janë aplikuar herë pas herë, veprimet dhe kushtin financiar të Huamarrësit dhe vartësve të tij, nëse ka, dhe monitojë drejt dhe regjistrojë progresin e projektit (duke përfshirë kostot e tij dhe përfitimet e përfituara prej tij).

b) Huamarrësi:

1) Do të ketë regjistrimet e veta, llogaritë, situacionet financiare (duke përfshirë bilancin e tij, gjendjen e të ardhurave dhe gjendjen e ndryshimeve në pozicionin financiar dhe shërbimet për to) duke përfshirë ato që lidhen me llogaritë e projektit dhe regjistrimet, gjendjet e llogarive dhe financiare të vartësve të vet, për çdo vit fiskal që fillon më 1 janar 2000 të revizionuar nga revizorë të pavarur të pranueshëm nga Banka sipas principeve dhe standardeve ndërkombëtare të pranueshme të revizionimit;

2) Do t'i paraqesë Bankës sa më shpejt, por në ndonjë rast jo më vonë se 6 muaj pas fundit të çdo viti fiskal, (A) kopje të çertifikuara të gjendjeve të veta financiare për këtë vit fiskal të revizionuar në këtë mënyrë, (B) një raport të këtij revizionimi nga revizorë sipas kërkesave dhe me aq hollësi sa mund t'i kërkojë Banka në mënyrë të arsyeshme, (C) një situacion të transaksioneve financiare ndërmjet Huamarrësit dhe çdo vartësi të tij dhe filial, dhe (D) një evidencë të realizimeve sipas marrëveshjeve financiare në Seksonin 4.03, 4.04 dhe 4.05; dhe

3) Do t'i paraqesë Bankës, informacion tjetër lidhur me ato regjistrime, llogari, situacione

financiare dhe revizionimin që Banka mund të kërkojë arsyeshëm herë pas herë.

SEKSIONI 4.02. RAPORTI I PUNËS

a) Përveç rastit kur Banka është dakort ndryshe Huamarrësi, për çdo Vit Fiskal, që fillon me vitin fiskal 2001, do të mbajë një përqindje pune para taksave midis shpenzimeve të prodhimit dhe të ardhurave nga prodhimi jo më shumë se 60%.

b) Për qëllime të këtij seksioni:

1. Termi "Shpenzime totale të punës" do të thotë, shpenzimet në para në dorë (cash) të Huamarrësit lidhur me veprimtaritë duke përfshirë administrimin dhe kostot e mirëmbajtjes por duke përjashtuar interesin dhe detyrime të tjera mbi Debitin, të gjitha shpenzimet jo në cash për atë periudhë dhe çdo shpenzim kapital dhe

2. Termi "Të ardhura totale operative" do të thotë të ardhurat nga të gjitha burimet për veprimtaritë në atë periudhë.

SEKSIONI 4.03. RAPORTI I DEBITEVE TË MBULIMIT TË SHËRBIMIT

1. Huamarrësi do të mbajë duke filluar me 1 Janar 2001, një përqindje minimale të Mbulimit të Shërbimit të Debitit prej 1.25 deri më 31 Dhjetor 2005 dhe 1.5 pas kësaj date.

2. Termi "Qarkullim Monetar i Lirë" do të thotë për çdo periudhë, përfitimet e Huamarrësit gjatë asaj periudhe para amortizimit, interesit dhe shpenzimeve taksore (plus shumat e huave afatgjata, duke përfshirë Huanë e marrë gjatë kësaj periudhe) minus taksat e paguara, plus uljet për atë periudhë (sipas rastit, minus rritjet për atë periudhë) në kapitalin e punës dhe minus shpenzimet kapitale të bëra gjatë asaj periudhe;

3. Termi "Shërbimi i Debitit" do të thotë, për çdo periudhë, shuma e të gjitha pagesave të principalit të planifikuar, interesit, pagesave dhe detyrimeve për të gjithë borxhin e Huamarrësit duke përfshirë këtë Marrëveshje dhe Marrëveshjet e Bashkëfinancimit; dhe

4. Kurdoherë për qëllime të këtij Seksioni do të jetë e nevojshme të vlerësohet, në termat e monedhës së Garantit, Borxhi i paguar në monedhë tjetër, ky vlerësim do të bëhet mbi bazën e përqindjes predominuese të këmbimit, ku ajo monedhë tjetër në kohën e këtij vlerësimi është e arritshme ligjërisht për shërbimin e këtij borxhi ose, në mungesë të asaj përqindje mbi bazën e raportit të këmbimit të pranueshme për Bankën.

SEKSIONI 4.04. TË ARDHURAT PËR T'U ARKËTUAR (KLIENTË)

Përveçse kur Banka është dakort ndryshe, Huamarrësi do të arkëtojë llogaritë sipas shitjeve të energjisë konsumatorëve lokalë në mënyrë të tillë, që të ardhurat e paarkëtuara të mos kalojnë 120 ditë faturimesh mesatare për këtë shitje gjatë Vitit Fiskal që fillon me 1 Janar 2000 dhe 1 Janar 2001 dhe 90 ditë faturimesh mesatare për këto shitje në çdo Vit Fiskal pas këtyre datave, me faturime mesatare për çdo rast të llogaritur për 12 muajt e parë.

SEKSIONI 4.05. MARRËVESHJET NEGATIVE FINANCIARE

a) Huamarrësi, përveç se kur Banka është dakort ndryshe, nuk do të ndërmarrë ndonjë veprim të mëposhtëm, dhe do t'i paraqesë Bankës gjithë informacionin që Banka mund të kërkojë më tej, si:

1. të hyjë në ndonjë marrëveshje, ose marrëveshje garancie ose në një farë mënyre ose për shkak të ndonjë kushti të detyrohet për të gjithë ose pjesë të ndonjë detyrimi financiar ose të ndonjë personi tjetër, duke përfshirë çdo vartës ose filial.

2. të hyjë në ndonjë transaksion me ndonjë person përveç me ndonjë kurs të thjeshtë biznesi, me terma të zakonta tregtare dhe mbi bazën e mundësive që ka ose të krijojë ndonjë agjenci të vetme dhe

eskluzive blerje ose shitje ose të hyjë në ndonjë transaksion ku Huamarrësi mund të paguajë më shumë se çmimi i plotë i punëve të mëparshme (subjekt të mosllogarive të tregut normal) për prodhimet dhe shërbimet e veta.

3. të hyjë në ndonjë partneritet për ndarjen e fitimit ose marrëveshje gojore ose si të tilla ku të ardhurat ose fitimet e Huamarrësit janë ose mund të ndahen me një person tjetër.

4. të bëjë ndonjë parapagesë (vullnetarisht ose jo) ose të riblejë ndonjë debit (jo Huaje) ose të bëjë ndonjë ripagesë të ndonjë debiti të tillë përveçse kur ai do të bëjë, një parapagesë proporcionale, në se Banka e kërkon, ose ripagesë të shumës së principalit atëherë të papaguar të Huasë sipas klauzolave të Seksionit 3.07 të Termave dhe Kushteve Standarte (me përjashtim që shuma e çdo parapagese nuk do të jetë subjekt i kërkesave të Shumës Minimale të Parapagesës).

5. të shesë, transferojë, japë me qera gjithë ato pjesë të aseteve të saj (nëse në një transaksion të vetëm ose në disa transaksione, që kanë lidhje, ose ndryshe,

6. të ndërmarrë ose lejojë ndonjë shkrirje, konsolidim, ose riorganizim; ose

7. të ndërmarrë ose lejojë ndonjë ristrukturim, që mund të ketë efekt material mbi Huamarrësin dhe veprimtaritë e tij.

b) Huamarrësi, ndryshe nëse njofton Bankën të paktën 30 ditë përpara, nuk do të ndërmarrë veprimet e mëposhtme dhe do t'i japë Bankës të gjithë informacionin rreth saj me kërkesë të Bankës.

1. të hyjë në ndonjë kontratë menaxhimi ose marrëveshje të përafërt ku biznesi ose veprimtaritë e saj drejtohen nga person tjetër, duke përfshirë çdo Vartës apo Filial (përveç kontratave të bëra sipas Programit të Asistencës Menaxhimit të pranueshme për Bankën); ose

2. të formojë ndonjë njësi vartëse, të krijojë ose lejojë hua ose të tjera, ose depozita (përveç depozitave me Bankat tregtare në një kurs të thjeshtë të biznesit) me persona të tjerë ose investime me ndonjë person tjetër, përfshirë ndonjë Vartës apo Filial me kusht që, gjithsesi Huamarrësi mund të investojë në siguracionet e tregut, afatshkurtëra për të përdorur burimet e veta të pashfrytëzuara.

SEKSIONI 4.06. NDJEKJA E BIZNESIT DHE VEPRIMTARIVE

Huamarrësi, përveç se kur Banka është dakort ndryshe:

a) do të ndjekë biznesin dhe veprimtaritë e veta (1) sipas standarteve të njohura ndërkombëtare administrative, financiare, inxhinierike dhe të tjera praktika.

2. sipas faktorëve ekologjikë dhe ambientale, dhe

3. sipas të gjitha politikave principale operuese

b) do të ndërmarrë menjëherë të gjitha veprimtaritë brenda mundësive për t'iu përmbajtur ekzistencës së vet ligjore, për të vazhduar veprimtaritë dhe për të kërkuar, përmbajtur dhe përmirësuar të gjitha të drejtat, pasuritë, energjitë, privilegjet dhe të drejtat që janë të nevojshme për të ndjekur biznesin, përfshirë zbatimin e projektit

c) do të shesë, japë me para ose të vejë në dispozicion ndonjë nga asetet e veta që kërkohen për të realizuar me sukses veprimtaritë ose që vënia në dispozicion të së cilës mund të paragjykojë aftësitë e saj për të kryer në mënyrë të kënaqshme çdo detyrim sipas kësaj Marrëveshjeje.

d) do të njoftojë menjëherë Bankën për çdo propozim që duhet për ndryshim, suspendim ose shfuqizimin e ndonjë klauzole të Statutit dhe t'i paraqesë Bankës një mundësi për të komentuar për këtë propozim para se të ndërmerret ndonjë veprim.

e) do të marrë dhe përmbahet me përgjegjësi ose të ndërtojë klauzola të tjera të pranueshme për Bankën për sa i përket sigurisë përkundrejt këtyre risqeve të humbjeve, dëmtimit dhe detyrime në ato shuma që janë të pranueshme nga praktikat e drejta.

f) gjatë gjithë kohës do të punojë për të mirëmbajtur ndërmarrjen, pajisjet, mjetet dhe pasurinë tjetër në gjendje të mirë pune dhe menjëherë sipas nevojave të bëjë të gjitha riparimet e nevojshme dhe zëvendësimet për to sipas praktikave të shëndosha;

g) do të sigurojë që biznesi, veprimtaritë dhe pajisjet të mos dëmtohen materialisht nga gjendja e parregullt e kompjuterave ose pajisjeve të tjera në njohjen e kohës edhe pas 31 dhjetorit 1999.

Neni 5
Suspendimi, Përshpejtimi, Anulimi

SEKSIONI 5.01. SUSPENDIMI

Për sa më poshtë jepen specifikimet për qëllime të seksionit 7.01 (a) (XIV) në Kushtet dhe Termat Standarte:

(a) Kuadri legjislativ, rregullator i zbatueshëm në sektorin e energjisë në territorin e Garantit të ndryshojë, suspendohet, shfuqizohet, anulohet ose të mos zbatohet.

(b) Statutet të ndryshojnë, suspendohen, shfuqizohen, anulohen, ose të mos zbatohen.

(c) Huamarrësi të ndërmarrë ndonjë nga veprimtaritë sipas seksionit 4.02 (b) për të influencuar materialisht operimet ose kushtet financiare të Huamarrësit ose aftësitë e tij për të realizuar Projektin ose për të zbatuar detyrimet, sipas kësaj Marrëveshje.

(d) E drejta e Huamarrësit për të tërhequr shumat sipas çdo Marrëveshjeje bashkëfinancimi ku ai është palë të suspendohet, anulohet ose të përfundojë për të gjithë ose pjesë të shumës sipas termave të Marrëveshjes Bashkëfinanciare; ose

(e) E drejta e garantit për të marrë fonde granti sipas çdo Marrëveshjeje Bashkëfinancimi, ku ai është palë të suspendohet, anulohet ose përfundojë për të gjithë ose pjesë të fondit sipas Termave të Marrëveshjes së Bashkëfinancimit.

(f) Kontrolli i Huamarrësit t'i kalojë një pale që nuk përbën Garantin.

(g) Mosarritja nga ana e Huamarrësit ose e Garantit, sipas rastit, për të përmbushur detyrimet sipas çdo Marrëveshje Bashkëfinancimi, ku ato janë palë; me kusht që, sipas rastit, klauzolat e nënseksionit (d) dhe (e) më sipër të mos aplikohen kur Huamarrësi apo Garanti krijojnë fondet e duhura për Projektin nga burime të tjera, me aprovimin e Bankës, sipas kësaj Marrëveshjeje.

SEKSIONI 5.02. PËRSHPEJTIMI I MATURITETIT

Për sa më poshtë, specifikohet për qëllimet e seksionit 7.06 (f) të Termave dhe Kushteve Standarde, për çdo ngjarje sipas seksionit 5.01 që vlerësohet si ngjarje për përshpejtim.

Neni 6
Efektiviteti

SEKSIONI 6.01. KUSHTET PËR EFEKTIVITET

Për sa më poshtë jepen specifikime për qëllime të Seksionit 9.02 (c) të Termave dhe Kushteve Standarte, si të tjera kushte për efektivitetin e kësaj Marrëveshjeje:

(a) Si Llogaria Lokale e Projektit dhe Llogaria e Shërbimit të Huasë janë krijuar; dhe

(b) Çdo Marrëveshje e Bashkëfinancimit dhe Amendamentet e tjera në Termat e kësaj Marrëveshje Bashkëfinancimi të zbatohen dhe shpërndahen, dhe të gjitha kushtet për efektivitet ose për të drejtën e Huamarrësit për të bërë tërheqje, ose për të drejtën e Garantit për të tërhequr të realizohen.

SEKSIONI 6.02. KUSHTET PËR DISBURSIM

Për sa më poshtë, jepen specifikimet për kushtet e disbursimit.

(a) Huamarrësi do të krijojë Njësinë e Menaxhimit të Projektit (PMU); dhe

(b) Marrëveshja e Huasë së Lumit Drin dhe Marrëveshja e Huasë së PTD anulohen, dhe detyrimet që dalin prej tyre (jo Drin River Unwinding Costs – Kostot e Marrëveshjes së Mëparshme) – ripaguhen sipas termave dhe kushteve të pranueshme për Bankën; me kusht që, gjithsesi klauzolat e këtij Seksioni

nuk aplikohen me të drejtën e Bankës për të tërhequr sipas seksionit 2.03 (b).

SEKSIONI 6.03. OPINIONET LIGJORE

(a) Për qëllime të seksionit 9.03 (b) të Kushteve dhe Termave Standarde, opinionet ligjore për Huamarrësin do të jepen nga Shefi i Kabinetit të Drejtorit të Përgjithshëm.

(b) Për qëllime të Seksionit 9.03(b) të Kushteve dhe Termave Standarte, opinionet ligjore për Garantin do të jepen nga ministri i Drejtësisë.

SEKSIONI 6.04. MBYLLJA PËRFUNDIMTARE E KONTRATËS PAS NËNSHKRIMIT TË SAJ

Në 90 ditë pas datës së nënshkrimit të kësaj Marrëveshje për qëllime të Seksionit 9.04 të Kushteve dhe Termave Standarte, kontrata quhet e përfunduar.

Neni 7
Të tjera

SEKSIONI 7.01. VËREJTJE

Adresat e mëposhtme jepen për qëllime të Seksionit 10.01
të Kushteve dhe Termave Standarte

Për Huamarrësin:	**Për Bankën:**
Korporata Elektroenergjetike	Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim
Blloku "Vasil Shanto"	One Exchange Square
Tiranë – Albania	Londër E(2A2JN) United Kingdom
Për dijeni: Drejtorit të Përgjithshëm	Për dijeni: Operation Administration Unit
Faks: (355) (42) 320 46	Faks: (44) (20) 73 38 – 61 00
	Teleks: 8812161
	Answerback: EBRDLG

Për sa më sipër dëshmohet se palët në këtë Marrëveshje, duke vepruar të autorizuar në detyrë nga përfaqësuesit e tyre, firmosin këtë Marrëveshje në (katër) kopje dhe e dorëzojnë në (Londër, Angli) në datën dhe vitin e shkruajtur më lart.

Korporata Elektroenergjetike Shqiptare nga:
Emri: Prof.Dr. Farudin Hoxha
Titulli: Drejtor i Përgjithshëm

Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim nga:
Emri: Charles R.Frank, IR
Titulli: Zv/Presidenti i Parë

Schedule1. Përshkrimi i Projektit

1. Qëllimi i Projektit është të ndihmojë Huamarrësin për zhvillimin e sistemeve të transmetim shpërndarjes me objektiv përmirësimin e eficencës së energjisë nëpërmjet uljes së humbjeve teknike dhe

vjedhjeve të energjisë nëpërmjet përmirësimit të matjeve. Projekti gjithashtu do të mbështesë ristrukturimin e komercializimin e nënsektorëve të energjisë nëpërmjet dhënie ekspertësh.

2.2 Projekti përbëhet nga pjesët e mëposhtme, subjekt modifikimesh, nëse Banka dhe Huamarrësi do të jenë dakord herë pas herë.

A-1 Rehabilitimi i Hidrocentralit të Fierzës
a) Furnizimi dhe instalimi i pajisjeve mekanike
b) Furnizimi dhe instalimi i pajisjeve elektrike
c) Furnizimi dhe instalimi i pajisjeve të kontrollit dhe monitorimit
d) Furnizimi dhe instalimi i pajisjeve të sigurimit
e) Punët publike

A-2 Rehabilitimi i hidrocentralit të Vaut të Dejës
a) Furnizimi dhe instalimi i pajisjeve mekanike
b) Furnizimi dhe instalimi i pajisjeve elektrike
c) Furnizimi dhe instalimi i pajisjeve të kontrollit dhe monitorimit
d) Furnizimi dhe instalimi i pajisjeve të sigurimit
e) Punët publike

A-3 Rehabilitimi i Hidrocentralit të Ulëzës
a) Furnizimi dhe instalimi i pajisjeve mekanike
b) Furnizimi dhe instalimi i pajisjeve elektrike
c) Furnizimi dhe instalimi i pajisjeve të kontrollit dhe monitorimit
d) Furnizimi dhe instalimi i pajisjeve të sigurimit
e) Punët publike

A-4 Rehabilitimi i Hidrocentralit të Shkopetit
a) Furnizimi dhe instalimi i pajisjeve mekanike
b) Furnizimi dhe instalimi i pajisjeve elektrike
c) Furnizimi dhe instalimi i pajisjeve të kontrollit dhe monitorimit
d) Furnizimi dhe instalimi i pajisjeve të sigurimit
e) Punët publike

Pjesa B: Modernizimi i Sistemit të transmetim- shpërndarjes

B-1. ndërtimi i linjës 220 kv nga nënstacioni i Elbasanit numër 1 në nënstacionin e Elbasanit numër 2

B-2. Ndërtimi i linjës 110 kv nga Zemblak në Korçë dhe nënstacionit të ri në Zemblak

Pjesa C: Konsulentin e PMU dhe Supervizorin e Huamarrësit

Pjesa D: Drin River Unwinding Costs (Kostot e Marrëveshjes së Mëparshme)

Pjesa E: Interesi gjatë ndërtimit përfshirë interesi dhe pagesat e angazhimit gjatë periudhës para datës fillestare të ripagesës së Huasë

3. Projekti mendohet të përfundojë rreth 30 prillit 2002

Schedule 2. Kategoritë dhe Tërheqjet

1. Tabela që i bashkëngjitet këtij schedule përcakton kategoritë, shumën e huasë së dhënë për çdo kategori dhe përqindjen e shpenzimeve për t'u financuar në çdo kategori.

2. Nëse nuk i përmbahemi klauzolave të paragrafit 2 më sipër, nuk do të bëhet asnjë tërheqje përsa i përket

a) shpenzimeve për Pjesët B-1 dhe B-2 sipas kategorisë 1 derisa të jetë ndërtuar Programi i

Asistencës së Menaxhimit.

3. Në emër të Huamarrësit do të caktohet Banka të bëjë Tërheqje për të bërë pagesa për interesa të Huasë gjatë projektit.

Shtojcë në Schedule 2

Kategoria	Shuma e Huasë së dhënës në monedhën e huasë	Përqindja e shpenzimeve për t'u financuar
1) Furnizimi dhe instalimi dhe he shërbimet e përbashkëta për për Pjesën A; 1-d, 2-d, 3-d, 4-d, 3-b, 4-4 b, 1-c, 2-c, 3-c,4-c Për Pjesën B: B-1 dhe B-2	11.5 10 milionë	Vlera 100% e kontratës për kontratat, përjashtuar taksat lokale dhe detyrimet, subjekt i tenderave ndërkombëtare
2) Shërbimet e konsulencës për për Pjesën c	3.1 milionë	Vlera 100% e kontratës përjashtuar taksat lokale dhe detyrimet
3) Kostot për pjesën D dhe Pjesën E	4.6 milionë	
4) të pashpërndara	0.8 milionë	
Totali	30 milionë	

Schedule 3. Ulja e Humbjeve të Energjisë

Humbjet maksimale në sistemin shqiptar të transmetim shpërndarjes

Viti	2000	2001	2002	2003	2004	2005
Humbjet %	45	40	35	30	30	30

Viti	2006	2007	2008	2009	2010	2011
Humbjet %	30	30	30	30	30	30

Humbjet në sistemin e transmetim shpërndarjes përcaktohen sipas:

Përqindja e humbjeve = (S-D)/S

Ku, S është shuma e energjisë së furnizuar në rrjetin shqiptar nga prodhimi vendas plus importin minus eksportin;

D është shuma e energjisë së faturuar deri në konsumatorin e fundit.

LIGJ
Nr. 8587, datë 15.3.2000

PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR.8433, DATË 21.12.1998 "PËR PËRCAKTIMIN E FORMËS DHE TË STRUKTURËS SË FORMULËS SË PRIVATIZIMIT TË BANKËS KOMBËTARE TREGTARE SH.A."

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:

Në ligjin nr.8433, datë 21.12.1998 "Për përcaktimin e formës dhe të strukturës së formulës së privatizimit të Bankës Kombëtare Tregtare sh.a." bëhen këto shtesa:

Neni 1

Në nenin 1, në rreshtin e dytë, pas fjalëve "nëpërmjet shitjes", shtohen fjalët: "ose shitjes me kusht "

Po në këtë nen, pas paragrafit të parë, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Në rast se marrëveshja për transferimin e të drejtës së pronësisë të aksioneve të Bankës Kombëtare Tregtare sh.a. do të bëhet me kushte, kjo marrëveshje duhet të miratohet nga Kuvendi."

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2579, datë 27.3.2000, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

LIGJ
Nr.8588, datë 15.3.2000

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E GJYKATËS SË LARTË TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 6, 81 pika 2 shkronja "a" dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I GJYKATËS SË LARTË

Neni 1
Përbërja e Gjykatës së Lartë

Gjykata e Lartë përbëhet nga 17 gjyqtarë.

Neni 2
Selia e Gjykatës së Lartë

Gjykata e Lartë e ka selinë në Tiranë.

Neni 3
Kushtet për t'u emëruar gjyqtar i Gjykatës së Lartë

Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë emërohen nga radhët e gjyqtarëve me vjetërsi jo më pak se 10 vjet ose nga radhët e juristëve të shquar, që e kanë ushtruar këtë profesion jo më pak se 15 vjet.

Neni 4
Procedura e emërimit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë

Gjyqtari i Gjykatës së Lartë emërohet nga Presidenti i Republikës, pasi është marrë më parë pëlqimi i Kuvendit.

Neni 5

Mandati i gjyqtarit të Gjykatës së Lartë fillon me hyrjen në fuqi të dekretit të Presidentit për emërimin e tij.

Mandati i Kryetarit të Gjykatës së Lartë llogaritet brenda mandatit të gjyqtarit të kësaj gjykate.

Neni 6
Mbarimi i parakohshëm i mandatit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë

Në rastet e parashikuara në nenin 139 të Kushtetutës, Kryetari i Gjykatës së Lartë ose çdo gjyqtar i saj, i propozon Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë të deklarojë me vendim mbarimin e mandatit të gjyqtarit të kësaj gjykate.

Neni 7
Kryetari i Gjykatës së Lartë

Gjykata e Lartë përfaqësohet nga Kryetari.

Kryetari i Gjykatës së Lartë kryen këto detyra:

a) Drejton Kolegjet e Bashkuara.

b) Bën ndarjen e gjyqtarëve në kolegje.

c) Kujdeset për funksionimin normal të Gjykatës së Lartë.

ç) Emëron dhe shkarkon ndihmësit ligjorë.
d) Emëron dhe shkarkon personelin e shërbimeve ndihmëse.
dh) Bën kërkesat për buxhetin vjetor të Gjykatës së Lartë dhe mbikëqyr zbatimin e tij.
e) Miraton strukturën, organikën dhe rregullat e brendshme të Gjykatës së Lartë.
Kryetari i Gjykatës së Lartë kryen edhe detyra të tjera që parashikohen me ligj.
Kryetari i Gjykatës së Lartë në ushtrimin e funksioneve të tij ndihmohet nga këshilltarët dhe personeli ndihmës.

Neni 8
Zëvendësimi i Kryetarit

Në rastet kur Kryetari nuk mund të kryejë detyrat e tij, zëvendësohet nga Kryetari i Kolegjit Civil në kryerjen e detyrave që parashikohen në shkronjat "a", "c" dhe "dh" të nenit 7 të këtij ligji.

Neni 9
Këshillimi me gjyqtarët

Kryetari i Gjykatës së Lartë këshillohet me gjyqtarët, sidomos për:
a) strukturën e Gjykatës së Lartë;
b) rregullat e brendshme të funksionimit të Gjykatës së Lartë;
c) kërkesat për buxhetin e Gjykatës së Lartë;
ç) ndarjen dhe lëvizjen e gjyqtarëve në kolegje.

Neni 10
Kolegjet

Gjykata e Lartë organizohet në Kolegjin Civil dhe Kolegjin Penal.
Çështjet penale ushtarake gjykohen nga Kolegji Penal, ndërsa çështjet me karakter tregtar, administrativ, familjar, të punës etj. gjykohen nga Kolegji Civil.
Kryetari i Gjykatës së Lartë, pasi merr mendimin e gjyqtarëve, mund t'i lëvizë ata nga një kolegj në tjetrin, për arsye të ngarkesës së punës dhe të funksionimit normal të gjykatës.

Neni 11
Kryetari i kolegjit

Kryetari i kolegjit zgjidhet nga anëtarët e tij me shumicë votash për një periudhë njëvjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje.

Neni 12
Kompetencat e kolegjeve

Kolegjet e Gjykatës së Lartë gjykojnë ankimet për çështje gjyqësore sipas rregullave të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile dhe në Kodin e Procedurës Penale.

Neni 13
Trupi gjykues

Kolegjet e Gjykatës së Lartë gjykojnë me trup gjykues të përbërë nga 5 gjyqtarë.

Kur trupi gjykues nuk mund të formohet nga gjyqtarët e një kolegji, ai plotësohet me gjyqtarë të kolegjit tjetër. Këta gjyqtarë caktohen me short.

Kur në gjykim merr pjesë Kryetari i Gjykatës së Lartë, ai kryeson trupin gjykues. Në të gjitha rastet e tjera trupin gjykues e kryeson kryetari i kolegjit përkatës dhe, në mungesë të tij, gjyqtari më i vjetër.

Neni 14
Çështjet që gjykohen në Kolegjet e Bashkuara

Gjykata e Lartë gjykon në Kolegjet e Bashkuara:

a) rastet e parashikuara në Kodin e Procedurës Civile dhe Kodin e Procedurës Penale;

b) ankimet kundër vendimeve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë;

c) kërkesat për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore;

ç) raste të tjera, të parashikuara me ligj.

Neni 15
Gjykimi në Kolegjet e Bashkuara

Kur Gjykata e Lartë gjykon në Kolegje të Bashkuara, seanca kryesohet nga Kryetari i Gjykatës së Lartë.

Në mungesë të tij seancën e kryeson Kryetari i Kolegjit Civil.

Kur Gjykata e Lartë gjykon në Kolegje të Bashkuara, caktohen me short 2 relatorë, të cilët, në mënyrë të pavarur, përgatisin relacionet dhe i paraqesin ato në gjykim.

Neni 16
Kuorumi

Kolegjet e Bashkuara gjykojnë kur në to marrin pjesë jo më pak se dy të tretat e të gjithë gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë.

Vendimi merret me shumicën e votave të gjyqtarëve që marrin pjesë në gjykim.

Neni 17
Njësimi ose ndryshimi i praktikës gjyqësore

Njësimi ose ndryshimi i praktikës gjyqësore bëhet nga Kolegjet e Bashkuara kur:

a) kërkohet nga secili kolegj i Gjykatës së Lartë;

b) kërkohet nga Kryetari i Gjykatës së Lartë;

c) Kolegjet e Bashkuara e çmojnë të nevojshme një gjë të tillë.

Neni 18
Gjykimi gjatë kohës së pushimeve vjetore

Gjatë kohës së pushimeve vjetore, një numër i nevojshëm gjyqtarësh caktohen me short për të gjykuar çështjet që, sipas ligjit, vlerësohen të ngutshme.

Neni 19
Vendimet dhe botimi i tyre

Vendimet e Gjykatës së Lartë shpallen të arsyetuara jo më vonë se 30 ditë nga përfundimi i shqyrtimit gjyqësor.

Vendimet e kolegjeve të Gjykatës së Lartë, së bashku me mendimet e pakicës, botohen në Buletinin Periodik të Gjykatës së Lartë.

Vendimet për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore botohen në numrin më të parë të Fletores Zyrtare.

Neni 20
Ndihmësit ligjorë

Gjyqtari i Gjykatës së Lartë ka deri në dy ndihmës ligjorë dhe personin e shërbimit.

Ndihmësit ligjorë përzgjidhen nga vetë gjyqtarët e Gjykatës së Lartë ndërmjet juristëve që plotësojnë kushtet ligjore për t'u emëruar gjyqtarë të gjykatës së shkallës së parë ose të gjykatës së apelit. Ata emërohen nga Kryetari i Gjykatës së Lartë.

Ndihmësit ligjorë përfitojnë përkatësisht pagën e gjyqtarit të shkallës së parë ose të gjykatës së apelit.

Ndihmësi ligjor largohet nga detyra me urdhër të Kryetarit të Gjykatës së lartë, me propozimin e gjyqtarit përkatës.

Kur largimi nga detyra është bërë pa arsye të përligjura, ai ka të drejtën vetëm të shpërblimit të dëmit deri në shumën e pagës vjetore.

Neni 21
Detyrat e ndihmësit ligjor

Ndihmësit ligjorë studiojnë ankimet, dosjet gjyqësore, përgatisin relacionet për çështjet që janë në gjykim duke dhënë mendimin e tyre, u përgjigjen ankesave, përgatisin materialet e nevojshme, si dhe kryejnë çdo detyrë tjetër që u ngarkohet nga gjyqtari i Gjykatës së Lartë.

KREU II
STATUSI I GJYQTARIT TË GJYKATËS SË LARTË

Neni 22

Paga e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë është e barabartë me pagën e ministrit, ndërsa ajo e Kryetarit të Gjykatës së Lartë, 20 për qind më e lartë se paga e gjyqtarit të kësaj gjykate.

Neni 23

Gjyqtarit të Gjykatës së Lartë dhe bashkëshortes (bashkëshortit) të tij/saj u njihet e drejta e pajisjes me pasaportë diplomatike edhe për tre vjet pas mbarimit të mandatit.

Neni 24

Trajtimi protokollar dhe shëndetësor i anëtarëve të Gjykatës së Lartë, është i njëjtë me atë të deputetit.

Neni 25

Me plotësimin e mandatit, sipas kushteve të parashikuara në nenin 136 pika 3 të Kushtetutës, gjyqtari i Gjykatës së Lartë, me kërkesën e tij, emërohet gjyqtar në gjykatën e apelit.

KREU III
ADMINISTRIMI I SHËRBIMEVE TË GJYKATËS SË LARTË

Neni 26
Kancelari i Gjykatës së Lartë

Kancelari drejton shërbimet ndihmëse në Gjykatën e Lartë.

Kancelar emërohet një jurist, i cili e ka ushtruar profesionin e juristit për një periudhë jo më pak se 7 vjet.

Kancelari emërohet dhe shkarkohet nga Kryetari i Gjykatës së Lartë.

Neni 27
Administrimi i shërbimeve

Kancelari organizon shortin gjyqësor.

Kancelari i propozon Kryetarit të Gjykatës së Lartë emërimin dhe shkarkimin e personelit të shërbimeve ndihmëse të Gjykatës së Lartë.

Neni 28
Shërbimet ndihmëse të Gjykatës së Lartë

Shërbimet ndihmëse në Gjykatën e Lartë kryhen nga sekretaria gjyqësore, sektori i administratës, i financës, i informatizimit, i regjistrimit, i ruajtjes së dokumenteve, i ruajtjes së rendit të brendshëm, i studimeve e marrëdhënieve me jashtë dhe biblioteka.

Për shërbime të tjera ndihmëse, Kryetari i Gjykatës së Lartë, me propozimin e Kancelarit, mund të krijojë sektorë të tjerë.

Neni 29
Garantimi i rendit dhe i sigurisë

Për të garantuar rendin dhe sigurinë, pranë Gjykatës së Lartë vepron, sipas urdhërave të Kryetarit të kësaj Gjykate, shërbimi i vazhdueshëm i policisë.

KREU IV
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 30

Ngarkohet Këshilli i Ministrave për nxjerrjen e akteve nënligjore për zbatimin e dispozitave të këtij ligji në lidhje me të drejtat financiare dhe protokollare të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.

Neni 31

Ligji nr.8362, datë 1.7.1998 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Kasacionit”, si dhe çdo dispozitë që bie ndesh me këtë ligj, shfuqizohen.

Për të gjitha problemet e tjera që nuk gjejnë zgjidhje në këtë ligj, zbatohen dispozitat e ligjit nr.8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 32

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2589, datë 3.4.2000, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

LIGJ
Nr.8590, datë 23.3.2000

PËR MIRATIMIN E “MARRËVESHJES SË KONCENSIONIT TË FORMËS “BOT” PËR UZINËN E FERROKROMIT NË ELBASAN DHE PËR MINIERAT E KROMIT TË PRRENJASIT E POJSKËS, NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË PUBLIKE DHE PRIVATIZIMIT DHE SHOQËRISË ITALIANE DARFO S.P.A.” DHE DHËNIEN E DISA STIMUJVE DHE GARANCIVE PËR KONCENSIONARIN E KËSAJ MARRËVESHJEJE

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:

Neni 1

Miratohet “Marrëveshja e koncensionit e formës “BOT” për Uzinën e Ferrokromit në Elbasan dhe për minierat e kromit të Prrenjasit e Pojskës, ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Shoqërisë Italiane DARFO s.p.a.”, sipas marrëveshjes që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Në “Marrëveshjen e koncensionit të formës “BOT” për Uzinën e Ferrokromit në Elbasan dhe për minierat e kromit të Prrenjasit e Pojskës, ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Shoqërisë Italiane DARFO s.p.a., kjo e fundit, me cilësinë e palës koncensionare, nëpërmjet shoqërisë koncensionare të themeluar prej saj, për një afat kohor katërvjeçar, sipas marrëveshjes së koncensionit, përjashtohet nga detyrimet e taksës doganore edhe TVSH-ja për makineritë, linjat e pajisjet që do të përdoren për investime, sipas projektit.

Neni 3

Palët kontraktuese bien dakord ndërmjet tyre për zbatimin e detyrimit të parashikuar në nenin 11

pika 4 të ligjit nr.7973, datë 26.7.1995 “Për koncensionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë”

Neni 4

Me hyrjen në fuqi të marrëveshjes së koncensionit, Këshilli i Ministrave trajton detyrimet ndaj buxhetit të shtetit dhe të tretëve, që janë objekt i koncensionit.

Neni 5

Këshilli i Ministrave, me hyrjen në fuqi të marrëveshjes së koncensionit, në zbatim të ligjit nr.8562, datë 22.12.1999, me të ardhurat që do të sigurohen nga zbatimi i kësaj marrëveshjeje, trajton punonjësit që do të dalin të tepërt.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2588, datë 3.4.2000, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

MARRËVESHJE KONCESIONI

E lidhur midis:

Qeverisë së Republikës të Shqipërisë, e përfaqësuar ligjërisht nga Ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit të Republikës së Shqipërisë, Mustafa Muçi

Dhe

Shoqërisë aksionere sipas së drejtës italiane të emërtuar : “DARFO” S.p.A., me seli në DARFO (Brescia), Itali Via A.Bonara nr.12, më poshtë referuar si “Koncesionari” i përfaqësuar për qëllimin e negocimeve dhe nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje Koncesioni, nga Ing. Alessandro Zecca, në bazë të prokurës së lëshuar më 13 dhjetor 1999 nga Gian Franco Banzato, në cilësinë e Presidentit të Shoqërisë “DARFO” S.p.A., që i bashkëngjitet kësaj Marrëveshjeje Koncesioni.

Meqenëse ekzistojnë këto kushte paraprake:

- Në kuadrin e zhvillimit të ekonomisë së vendit, Qeveria Shqiptare i ka dhënë një rol prioritar zhvillimit të industrisë minerare në përgjithësi;
- Koncesionari është i interesuar të investojë në industrinë minerare për racionalizimin dhe vënien në funksionim të plotë të stabilimentit të ferrokromit të ndodhur në Elbasan dhe të minierave të Prrenjasit dhe të Pojskës në afatet dhe kushtet e përfshira në propozimin e paraqitur dhe miratuar nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë (më poshtë “Projekti”);
- Palët kanë rënë dakord dhe marrin përsipër të bashkëpunojnë plotësisht me qëllim për realizimin e plotë të Projektit;
- Neni 3, pika 9 e Ligjit nr.7973, datë 26.07.1995 “Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në

shërbimet publike dhe infrastrukturë" (ndryshuar me akte të tjera ligjore), më poshtë referuar si "Ligji për Koncesionet" lejon, me miratimin paraprak të Këshillit të Ministrave, dhënien e koncesionit dhe negocimet e nënshkrimin e kontratave të shfrytëzimit, administrimit dhe rehabilitimit;

Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 7 të ligjit "Për Koncesionet" ka shqyrtuar dhe ka miratuar propozimin e paraqitur nga "DARFO" S.p.A., VKM Nr.508, datë 08.11.1999, duke i dhënë shoqërisë DARFO S.p.A. një koncesion BOT për minierat e Prrenjasit dhe Pojskës dhe për Stabilimentin e Ferrokromit Elbasan;

Këshilli i Ministrave i ka besuar Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Ministrisë së Financave negocimin e kësaj Marrëveshjeje Koncesioni.

Palët kanë rënë dakord sa më poshtë :

Neni 1
Përkufizime

Për zbatimin dhe interpretimin e kësaj Kontrate Koncesioni, do të zbatohen përkufizimet e mëposhtme :

Marrëveshje: Ky dokument dhe anekset e tij;

Koncesionari: Shoqëria aksionere e së drejtës italiane e emërtuar "DARFO" S.p.A. me seli në DARFO (Brescia), Itali, Via A.Bonara nr.12, e përfaqësuar ligjërisht për negocimin dhe nënshkrimin e kësaj kontrate, nga ing.Alessandro Zecca, në bazë të prokurës së lëshuar më 13 dhjetor 1999 nga Z.Gian Franco Banzato, në cilësinë e Presidentit të Shoqërisë "DARFO" S.p.A.

Kontratat: Të gjitha kontratat e përfunduara për të siguruar shërbimet, pajisjet dhe gjithçka tjetër të nevojshme për realizimin e Projektit;

Forca Madhore: Në kuptim të kësaj kontrate, forcë madhore do të konsiderohen katastrofat e natyrës, përmbytjet, tërmetet dhe lufta;

Sipërmarrës: Të gjithë nënkontraktorët dhe furnizuesit për zbatimin, ndërtimin, furnizimin e bazës materiale dhe të pajisjeve teknologjike të nevojshme për Projektin;

Ndryshimi i ligjit: Do të thotë çdo akt ligjor i miratuar nga organet kompetente të Republikës së Shqipërisë, që ka hyrë në fuqi pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, që ndryshon ligjin "Për Koncesionet".

Objekti i Marrëveshjes BOT: Miniera e Prrenjasit dhe e Pojskës dhe Uzina e Prodhimit të Ferrokromit të Elbasanit, sipas planimetrisë bashkëlidhur kësaj marrëveshjeje, Aneksi 1;

Organi Shtetëror i Autorizuar (OSHA): Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit të Republikës së Shqipërisë;

Palët: Tregon OSHA dhe Koncesionarin;

Lejet: Lejet, licensat dhe autorizimet që mund të kërkohen për zbatimin e plotë të Projektit;

Periudha e Koncesionit: Është 30 vjet që nga momenti i hyrjes në fuqi të marrëveshjes së koncesionit;

Projekt: Projekti i paraqitur në Aneksin 2, që ka për objekt rehabilitimin, modernizimin, financimin, administrimin dhe shfrytëzimin e Objektit të Koncesionit;

Shoqëria Koncesionare: Shoqëria tregtare e krijuar nga Koncesionari, në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 2
Objekti i Marrëveshjes

Kjo marrëveshje ka për objekt të legjitimojë dhënien në koncesion të Minierës së Përrenjasit, Minierës së Pojskës dhe të Uzinës së Ferrokromit Elbasan, sipas planimetrisë bashkëlidhur (Aneksi 1), që OSHA i përcaktuar nga Këshilli i Ministrave ia beson Koncesionarit për të realizuar rehabilitimin, modernizimin, financimin, administrimin dhe shfrytëzimin e këtij Objekti.

Neni 3

Kriteret specifike të punimeve

3.1 Kriteret specifike të punimeve do të jenë si më poshtë:

A. Në UFK Elbasan

Në fazën e parë është parashikuar të realizohen:

1. Mirëmbajtja e dy furrave ekzistuese në Elbasan, duke çuar prodhimin në 1600-1700 tonë në muaj ferrokrom. Afati 12 muaj.

2. Montimi i impiantit të coptimit me të gjithë aksesorët, si në projekt.

3. Montimi i laboratorit kimik me sallën e përgatitjes së kampioneve, sallën e analizave me rrugë të lëngshme, sallën e intrumenteve.

4. Montimi i impiantit të briketimit me aksesorët e vet si në projekt.

Në këtë fazë prodhimi parashikohet të arrijë rreth 20 000 tonë FeCr dhe investimi do të jetë rreth 4 miliardë lireta ose 2.065.827,96 Euro.

Në fazën e dytë është parashikuar të realizohen:

1. Instalimi i një furre të hapur "TAGLIAFERRI" nga 9 000 kw me të gjithë aksesorët dhe karakteristikat e saj si në projekt.

2. Instalimi i impiantit aspirator të tymrave të furrës me karakteristikat e tij si në projekt.

3. Çekiç shpues dhe tapatriçja.

4. Çekiçi shpues dhe tapatriçet e rrjedhjes së metalit (Impianti talian).

5. Impianti baltimor me aksesorët e tij si në projekt.

6. Impianti i evitimit të tymrave me karakteristikat e tij si në projekt.

7. Karikuesit dhe peshorja ku përfshihen tre karikues dhe stokatriçet, peshorja elektronike, vaska prej gize 4 copë dhe tenxhere gize 6 copë.

8. Punë ndërtimi dhe shërbimi të përshkruara si në projekt.

Në fund të fazës së dytë është parashikuar të prodhohen rreth 30 000 tonë FeCr në vit dhe Investimi do të jetë rreth 11 miliardë lireta ose 5.681.025,89 Euro.

Në fazën e tretë është parashikuar që të realizohen:

1. Instalimi i një furre "TAGLIAFERRI" me fuqi 14 000 kw dhe karakteristikat e saj si në projekt.

2. Instalimi i një impianti baltimor dhe me thithje tymrash 130 000-140 000 m3N/orë.

3. Janë parashikuar instalimet e shpuesve dhe tapatriçeve me karakteristikat e tyre si në projekt, të cilat kërkojnë edhe punë ndërtimi, bazamente, kat ngarkimi, gropa rrjedhëse, vrimë emergjence etj., procese të cilat do të përcaktohen gjatë fazës së parë të ndërhyrjes.

Në fund të fazës së tretë UFK Elbasan do të prodhojë 40000 ton FeCr në vit. Investimi në këtë fazë parashikohet të jetë rreth 12 miliard lireta ose 6.197.482,789 Euro.

Gjatë fazës së tretë do të kryhen edhe procese të tilla si :

1. Aplikimi i teknologjive të përparuara që lidhen me operacionin e ndarjes së metalit nga skorja, uljen e humbjeve të metalit në skorje, pakësimin e ndotjes së madhe të metalit nga skorjet.

2. Aplikimi i teknologjive të niveleve dopio të realizuara për herë të parë nga vetë DARFO, sipas përshkrimit të projektit.

3. Aplikimi i teknologjisë së shkrirjes së koncentrateve dhe pluhurave të kromit nëpërmjet briketimit të tyre.

4. Rikualifikimi i sh.a. Elbasan. Është parashikuar kualifikimi i punonjësve për të njohur teknologjitë e reja që do të aplikohen.

B. Në Minierën e Kromit Katjel

Është parashikuar të investohen makineri e pajisje 766 320 000 lireta ose 395 771.251 Euro. Investimet e nevojshme për punimet minerare kapitale e të shfrytëzimit dhe blerjen e makinerive e

pajisjeve do të realizohen sipas programit të paraqitur në projekt.

C. Miniera e Kromit Pojskë

1.1. Është parashikuar të investojë gjithsej 174 548 USD, prej të cilave makineri e pajisje 122 548 USD dhe për hapjen e punimeve të reja 52000 USD. Investimet e nevojshme për punimet minerare kapitale e të shfrytëzimit dhe blerjen e makinerive e pajisjeve do të realizohen sipas programit të paraqitur në projekt.

1.2. Specifikimet e detajuara për të gjitha zërat e investimeve dhe të ndara sipas fazave, paraqiten në aneksin 2.

1.3. Mosrespektimi i punimeve me treguesit teknikë cilësorë e sasiorë në afatet e përcaktuara në kohë në këtë nen, sipas projektit, në çdo fazë, e ngarkon koncesionarin që të pagujë një penalitet prej 0.05 % në ditë të vlerës së investimit të parealizuar për çdo 2 muaj vonesë.

Neni 4

Koha e fillimit të punimeve

Koncesionari do të fillojë punimet, sipas specifikimeve të përcaktuara në nenin 3, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të marrëveshjes.

Neni 5

Detyrimet e Koncesionarit

5.1. Koncesionari brenda 30 ditësh nga nënshkrimi i kësaj Marrëveshjeje do të formojë shoqëri koncesionare dhe do të bëjë regjistrimet e nevojshme për të lejuar shoqërinë të zhvillojë veprimtari në Shqipëri dhe do t'i nënshtrohet të gjitha dispozitave ligjore që rregullojnë veprimtarinë e shoqërive tregtare.

5.2. Koncesionari merr përsipër të kryejë gjithçka që nevojitet për realizimin e objektit të marrëveshjes që i është besuar në Koncesion në kushtet dhe afatet e përcaktuara në këtë Marrëveshje.

5.3. Të respektojë të drejtën e OSHA për ruajtjen e pronësisë të mjeteve kryesore të dhëna në koncesion për sa kohë që ato nuk do të transformohen nga koncesionari.

5.4. Të respektojë të drejtën e ndërhyrjes së OSHA deri në marrjen në dorë të projektit përkohësisht, në rastet kur konstatohen shkelje të rënda nga ana e koncesionarit që janë me pasoja për ecurinë e punës.

5.5. Në mënyrë të veçantë Koncesionari merr përsipër:

a) të realizojë Projektin, me mjetet e veta financiare, sipas specifikimeve të nenit 3;

b) të mbledhë të gjitha të dhënat dhe informacionet e nevojshme për projektin që do të zbatojë;

c) të marrë masa me qëllim që çdo punim i besuar në sipërmarrje të jetë përmbushur në përputhje me afatet dhe me cilësitë e parashikuara në këtë marrëveshje;

d) të ruajë dhe të administrojë Objektin e marrëveshjes gjatë gjithë periudhës së koncesionit, në përputhje me specifikimet e kësaj marrëveshjeje;

e) të respektojë dhe të kërkojë që të respektohen të gjitha dispozitat normative në fushën e punës, sigurimet shoqërore dhe sigurimet e parashikuara nga legjislacioni shqiptar;

f) të marrë të gjitha masat paraprake, me qëllim që të garantojë jetën dhe paprekshmërinë e punëtorëve dhe të tretëve, të shmangë dëmet ndaj pronës publike dhe private dhe të respektojë legjislacionin në fuqi dhe dispozitat e karakterit të përgjithshëm teknik, për të parandaluar çdo dëm dhe fatkeqësi në punë;

g) të lidhë kontrata sigurimi që mbulojnë të gjitha risqet e parashikueshme me një kohëzgjatje të njëjtë me periudhën e koncesionit;

h) koncesionari detyrohet që me përfundimin e periudhës së koncesionit t'i transferojë OSHA-së të rehabilituar objektet e marra në koncesion.

Neni 6
Detyrimet e Organit Shtetëror të Autorizuar

Organi Shtetëror i Autorizuar (OSHA) merr përsipër detyrimet e mëposhtme:

a) Të vërë në dispozicion të Koncesionarit Objektet e Koncesionit të përcaktuara në nenin 2, në gjendjen në të cilën ndodhen, siç është dokumentuar nga inventari që palët angazhohen të përpilojnë brenda fillimit të punimeve të përcaktuar në nenin 4 më sipër.

b) Të ofrojë asistencën e nevojshme për të organizuar sigurimin fizik të objekteve të Koncesionit nga Koncesionari në përputhje me Legjislacionin Shqiptar.

c) Të asistojë Koncesionarin në nxjerrjen e të gjitha autorizimeve të nevojshme, lejet e punimeve, lejet e ndërtimeve dhe ato të mbrojtjes së mjedisit sipas kërkesave të bëra nga Koncesionari, me kusht që kërkesat e bëra të jenë të përpiluara e të bëra në formën që kërkon ligji.

d) Të asistojë Koncesionarin për realizimin e projektit të tij pranë çdo organi autoriteti shqiptar e t'i garantojë Koncesionarit dhe/ose shoqërisë koncesionare ekskluzivitetin për realizimin e projektit, për objektet e dhëna në koncesion gjatë periudhës së koncesionit.

e) Të ruajë nivelin e tanishëm të çmimit të energjisë elektrike për industrinë e kromit për një periudhë 4-5-vjeçare, nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje Koncesioni, si dhe të asistojë koncesionarin në lidhjen e kontratave kolektive të punës.

Neni 7
Vlerësimi i Investimit

7.1. Investimi total i Koncesionarit do të jetë sa është parashikuar nga Projekti sipas specifikimeve të nenit 3.

7.2. Ndryshimet në projekt të bëhen me pëlqimin e të dy palëve dhe vlera e ndryshimeve nuk do të jetë më e madhe se plus/minus 10 % të vlerës së projektit.

Neni 8
Periudha e Koncesionit

8.1. Në bazë të kësaj Marrëveshjeje, OSHA i beson Koncesionarit të shfrytëzojë në mënyrë efektive për 30 vjet objektet e përcaktuara në nenin 2 të Marrëveshjes.

8.2. Periudha prej 30 vjetësh fillon nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, siç është parashikuar nga neni 18.

8.3. Periudha e përcaktuar në nenin 8.1 mund të ulet kur zgjidhet Marrëveshja për njërin nga rastet e përcaktuara në këtë Marrëveshje, ose të zgjatet në rastin kur verifikohet një ngjarje e forcës madhore.

Neni 9
Detyrim për Koncesionin

9.1. Koncesionari i paguan OSHA detyrimin për koncesion në shumën 1 milion e dyqind mijë dollarë amerikanë në vlerë dhe në kohë si më poshtë:

200 000 USD (dyqind mijë dollarë amerikanë), brenda 10 ditësh nga hyrja në fuqi e marrëveshjes.

200 000 USD (dyqind mijë dollarë amerikanë), 1 vit kalendarik nga pagesa e parë.

800 000 USD (tetëqindmijë dollarë amerikanë), deri në vitin 20 (njëzet) të koncesionit. Kjo pagesë do të bëhet në mënyrë proporcionale çdo vit, brenda 3-mujorit të parë të vitit.

9.2. Shuma e përcaktuar në pikën 9.1 do të derdhet në llogarinë rrjedhëse të OSHA, e cila do t'i

njoftohet me shkrim koncesionarit, me nënshkrimin e kontratës.

9.3. Mospagimi nga ana e koncesionit të detyrimit për koncesion në shumat dhe afatet e përcaktuara në pikën 9.1 e detyron koncesionarin që të paguajë penalitetin, prej 200 USD për çdo ditë vonesë.

Neni 10
Mbështetja për Projektin

Me miratim nga Kuvendi, të përjashtohet shoqëria koncesionare për afatin 4-vjeçar të periudhës së investimit, nga detyrimet e pagesës së taksave doganore dhe TVSH, për makineritë, linjat e pajisjet që do të përdoren për investime, sipas specifikimeve në projekt.

Neni 11
Zgjidhja e Marrëveshjes së Koncesionit

OSHA ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e Marrëveshjes së Koncesionit për rastet kur konstaton shkelje të detyrimeve të koncesionarit, në këtë marrëveshje, të cilat kompromentojnë grafikun e investimit, cilësinë e prodhimit dhe kushtet e tjera të marrëveshjes.

Koncesionari ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e Marrëveshjes së Koncesionit për rastet kur konstaton shkelje të detyrimeve të OSHA në këtë marrëveshje.

Kur nga ana e palëve verifikohen rastet e përmendura në pikat 9/1 ose 9/2, ato menjëherë do t'ja bëjnë të njohura këto raste palës tjetër dhe do të presin për një periudhë 30 ditore përgjigjen me shkrim të saj me argumentat përkatës. Mbi bazën e këtyre përgjigjeve palët do të vendosin për të filluar ose jo procedurën për zgjidhjen e marrëveshjes.

OSHA ka të drejtë të tërhiqet në mënyrë të njëanshme nga koncesioni nëse koncesionari brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e kësaj marrëveshjeje nuk paraqitet për të realizuar detyrimet kontraktuale ose refuzon të marrë në dorëzim objektin e koncesionit ose pjesë të tij.

Neni 12
Kontratat

Koncesionari ka të drejtë që të përdorë nënkontraktorë për realizimin e projektit.

Në të gjitha kontratat që do të lidhë koncesionari me të tretët, ai duhet të respektojë ligjet në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe parashikimet në këtë marrëveshje.

Koncesionari do të jetë përgjegjësi i vetëm kundrejt OSHA-së për zbatimin e përpiktë të projektit, pavarësisht nga kontratat që do të lidhen me të tretët.

OSHA-ja nuk ka asnjë detyrim kundrejt të tretëve që lidhen me koncesionarin dhe me këtë marrëveshje.

Neni 13
Sigurimet

Koncesionari për të gjithë periudhën e koncesionit dhe me shpenzimet e veta do të sigurojë Objektin e kësaj Marrëveshjeje që lidhen me projektin, me policën siguruese "All Riscs".

Koncesionari pajis OSHA-në me kopjet e dokumentacionit përkatës për sigurimet e bëra.

Në rast se objekti i siguruar shkatërrohet ose dëmtohet për shkak të rreziqeve për të cilat është siguruar, zhdëmtimet në para të marra nga koncesionari për këtë qëllim do të përdoren për të rindërtuar, riparuar, risistemuar dhe për të rikthyer objektin në gjendjen funksionuese në parametrat e projektit.

Neni 14
Riparimi dhe mirëmbajtja

Gjatë periudhës së koncesionit, koncesionari do të kryejë me shpenzimet e veta të gjitha riparimet dhe mirëmbajtjet e nevojshme, të zakonshme e të jashtëzakonshme, të objektit të përcaktuar në këtë marrëveshje, së bashku me inventarin përkatës që i bashkëlidhet dhe është pjesë përbërëse e tij, në përputhje me kushtet e përcaktuara ndërmjet palëve.

Neni 15
Kontrolli dhe Inspektimet

OSHA ruan të gjitha të drejtat kontrolluese mbi koncesionarin të parashikuara në nenin 13 të ligjit "Për Koncesionet" nr.7973, datë 26.07.1995.

OSHA-ja nëpërmjet personave të autorizuar ushtron kontroll për verifikimin e ecurisë së punimeve në përputhje me programin e përgjithshëm të realizimit të projektit të koncesionit, të paktën dy herë në vit dhe për probleme të veçanta sa herë të jetë e nevojshme.

Koncesionari nuk duhet të kufizojë në kontroll personat e autorizuar të OSHA-së. Ai duhet t'u japë atyre të gjitha sqarimet përkatëse.

Për të gjitha shkeljet e konstatuara nga koncesionari gjatë inspektimit në objekt, OSHA do të njoftojë me shkrim koncesionarin, i cili do të marrë masa për riparimin e tyre dhe mospërsëritjen në të ardhmen.

Neni 16
Legjislacioni i zbatueshëm

Interpretimi dhe zbatimi i kësaj marrëveshjeje do të bazohet në Legjislacionin Shqiptar në fuqi në momentin e nënshkrimit të saj.

Neni 17
Forca madhore

Palët nuk mund të jenë përgjegjëse në rast mospërmbushjeje të detyrimeve të tyre, të parashikuara nga kjo marrëveshje si pasojë e ndodhjes së njërës prej ngjarjeve të forcës madhore.

Në rastin kur një detyrim i parashikuar nga kjo marrëveshje vonohet ose bëhet i pamundur nga një ngjarje e forcës madhore, pala e dëmtuar është e detyruar të njoftojë me shkrim menjëherë palët e tjera, duke treguar motivet e pamundësisë ose vonesës dhe masat e marra për të evituar pasojat.

Gjatë zbatimit të marrëveshjes në rast se verifikohen ndodhi të forcës madhore, vonesa të mundshme ose mosrespektime të detyrimeve të palëve, ato nuk mund të jenë motiv për kërkesa reciproke për zhdëmtim.

Periudha e ndërprerjes dhe shtyrja e afateve të parashikuara për përmbushjen e detyrimeve përkatëse, konfirmohet me një procesverbal të përpiluar nga palët.

Periudha e koncesionit do të zgjatet me një periudhë të barabartë me atë të kohëzgjatjes së ngjarjes së forcës madhore dhe për një periudhë kohe të mëtejshme të nevojshme për të eleminuar pasojat dhe për të rifilluar punimet.

Neni 18
Hyrja në fuqi e Marrëveshjes së Koncesionit

Kjo Marrëveshje Koncesioni do të hyjë në fuqi kur të jetë firmosur nga Palët; të jetë ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në përputhje me ligjin "Për Koncesionet" nr.7973, datë 26.07.1995

(ndryshuar me akte të tjera ligjore).

Neni 19
Anekset

Anekset janë pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 20

Kjo Marrëveshje së bashku me të gjitha dokumentet dhe anekset, hartohet në gjuhët shqip, italisht dhe anglisht (UK). Për çdo problem që mund të dalë në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e kësaj marrëveshjeje, si gjuhë reference do të jetë gjuha angleze dhe varianti në gjuhën angleze do të konsiderohet ligjërisht i detyrueshëm.

Kjo marrëveshje është hartuar dhe nënshkruar në 3 (tri) kopje origjinale, 2 (dy) nga të cilat në dispozicion të OSHA-së dhe 1 (një) në dispozicion të Koncesionarit.

Neni 21
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Asnjë problem ose mosmarrëveshje midis palëve në lidhje me zbatimin dhe interpretimin e kësaj marrëveshjeje, nuk do të ndërpresë zbatimin e detyrimeve të palëve sipas kësaj marrëveshjeje.

Palët marrin përsipër në parim të zgjidhin në mirëkuptim çdo tip mosmarrëveshjeje.

Në rast se një gjë e tillë nuk është e mundur, çdo lloj mosmarrëveshjeje ose pretendim i lindur apo i lidhur me këtë marrëveshje, ose shkelja, zgjidhja apo pavlefshmëria e saj do të shqyrtohet dhe zgjidhet nëpërmjet arbitrimit sipas rregullave të arbitrimit UNICITRAL aktualisht në fuqi.

Arbitrazhi përbëhet prej tre arbitrash, dy prej të cilëve emërohen respektivisht prej

Palëve dhe i treti në funksionin e kryetarit, i emëruar nga arbitrat, ose në rast se nuk arrihet në mirëkuptim për zgjedhjen e kryetarit ai caktohet prej Kryetarit të Dhomës së Tregtisë së Parisit brenda 30 ditësh prej bërjes së kërkesës nga pala më e interesuar. Gjithsesi, përpara krijimit të Gjykatës së Arbitrave secila nga palët mund të kërkoj marrjen e masave të jashtëzakonshme për të siguruar objektin e padisë prej Gjykatës Kompetente. Këto masa do të konfirmohen ose revokohen prej Gjykatës së Arbitrave.

Arbitrazhi do të vendosë me paanësi dhe në mënyrë të njëllojtë për palët, duke depozituar vendimin brenda 90 ditëve prej datës së pranimit të detyrës së arbitrit të tretë.

Selia e Arbitrazhit do të jetë Parisi. Gjuha e arbitrimit do të jetë ajo angleze.

Neni 22
Bashkëpunimi midis OSHA-së dhe Koncesionarit

OSHA dhe Koncesionari marrin përsipër reciprokisht të bashkëpunojnë njëri me tjetrin, me qëllim që të garantohet zbatimi i çdo pjese të projektit.

Me përjashtim të rastit kur palët me shkrim kanë rënë dakord ndryshe, e gjithë korrespondenca do t'u dërgohet me shkrim personave të poshtëshënuar, me anë të një letre të dorëzuar dorazi, ose me letër të regjistruar, telegram ose faksimile.

Adresat dhe numrat e FAX-ve zyrtare që do të përdoren gjatë zbatimit të kësaj marrëveshjeje janë :

Për OSHA-në :	Për Koncesionarin :
Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit	DARFO S.p.A.
Sheshi"Skënderbej"	Via A.Bonara, nr.12

Tirana, ALBANIA

Për dijeni :
FAX

DARFO (Brescia), ITALIA

Për dijeni :
FAX

Palët marrin përsipër të ruajnë karakterin konfidencial të kësaj marrëveshjeje dhe të të gjithë informacionit teknik dhe tregtar që lidhet në një mënyrë apo në një tjetër me marrëveshjen e këtushme. Ky nen do të qëndrojë detyrimisht në fuqi për të gjithë periudhën e koncesionit dhe për 6 muaj pas përfundimit të tij.

Asnjë ndryshim i kësaj marrëveshjeje nuk do të konsiderohet i vlefshëm në rast se nuk është pranuar me shkrim nga të dyja palët.

Tiranë, 21.03.2000

PËR OSHA

Ministria e Ekonomisë Publike
Dhe Privatizimit

PËR KONCESIONARIN

DARFO S.p.A.

ANEKSI NR.1

OBJEKTET E KONCENSIONIT

Objektet e koncensionit me firmën DARFO S.p.A. janë:
a) Uzina e Ferrokromit Elbasan
b) Miniera e Kromit Prrenjas
c) Miniera e Kromit Pojskë
Në mënyrë më të detajuar, sipas planimetrive respektive të tyre, objektet përbëhen si më poshtë:

A) UZINA E FERROKROMIT ELBASAN
II. OBJEKTE

1. Reparti përgatitor
2. Reparti i shkrirje – derdhjes
3. Reparti i përpunimit
4. Magazina
5. Reparti i kompresorëve
6. Dushe e garderoba
7. Freskore e ujit komplet
8. Laboratori i kipit
9. Ofiçina dhe garazhi
10. Stacioni i furnizimit me karburant
11. Magazinat
12. Mensa
13. Zyrat e ndërtim-montimit
14. Zyrat e administratës
15. Ofiçina dhe kovaçhana
16. Gazgolderi
17. Stacioni i gazit

III. SHESHET

a. Brenda sheshit	9.41 ha
1. Sheshi industrial i uzinës me sipërfaqe	3.04 “
2. Ndërtim-kantieri dhe rruga	2.83 “
3. Vend për hedhjen e dherave	15.28 “

SHUMA

b. Jashtë sheshit	
1. Për rezervuarin e ujit avarisë kodër	0.2 ha
2. Vend tjetër në Papër për hedhjen e dherave	2.6 “
3. Rrugë për transportin e dherave	0.4 “
4. Degëzim i ri hekurudhor për në ferrokrom	0.4 “

SHUMA 3.6 “

Totali sheshe (a+b)	18.88 ha
Trualli neto	13.05 ha

B) MINIERA E KROMIT PRRENJAS
I. SEKTORI PRRENJAS

Objektet e kësaj miniere sipas planimetrisë 1:500, që është pjesë e studimit dhe përfaqëson planin e vendosjes së objekteve sipërfaqësore të repartit të jashtëm dhe administratës janë si më poshtë:

1. Zyrat e repartit të jashtëm
2. Kapanon makine
3. Reparti i motoristave
4. Magazinë
5. Reparti torno-axhusteri
6. Kapanon makine
7. Magazinë
8. Magazinë
9. Reparti xhenerik
10. Reparti i saldimit
11. Sallë kompresori
12. Reparti i zdrukthtarisë
13. Magazinë
14. Ish-kullë e ftohjes
15. Reparti i kovaçhanës
16. Reparti elektro-auto
17. Gropa e shërbimit
18. Depo karburanti
19. Magazinë
20. Kapanon makinash (në proces privatizimi)
21. Nënstacioni elektrik i qytetit Prrenjas (jashtë)
22. Ndërtesë private (jashtë koncensionit)
23. Ndërtesë private (jashtë koncensionit)
24. Zyrat e Minierës së Kromit, Prrenjas
25. Magazina e katit të dytë
26. Laboratori
27. Depo oksigjeni
28. Kabinë elektrike
29. Vendrojë

I. SEKTORI KATJEL

1. Zyra, MAGAZINË
2. Depo uji të pijshëm
3. Mensa
4. Dush, garderobë dhe gomisteri
5. Kovaçhana
6. Gabina elektrike TN 6 kv
7. Sallë kompresori
8. Zyra magazina të NNMM etalifere
9. Garderobë e MNMMetalifere

10. Kabinë elektrike e TN 6 kv
11. Hyrja e horizontit + 655
12. Ofiçinë
13. Shesh i depozitimit të kromit
14. Rrotulluese
15. Bunker sterili
16. Linjë elektrike TN 6 kv
17. Reparti elektromekanik

Konturet e vendburimit Katjel dhe zonës përreth t'i jepen nga:
a) Harta gjeologjike e vendburimit të kromit Katjel në shkallën 1:2 000
b) Harta gjeologostrukturore e rajonit Përrenjas në shkallën 1:25 000

C. MINIERA E KROMIT POJSKË

Sipas planimetrisë së Minierës së Pojskës në shkallë 1:1000, objektet janë si më poshtë:

1. Linjë hekurudhore (jashtë koncensionit)
2. Rruga e minierës
3. Rruga nacionale Pogradec-Tiranë (jashtë koncensionit)
4. Ofiçina
5. Galeria Nr. 710
6. Stacioni i pompave të ujit të pijshëm
7. Pallati i punëtorëve
8. Magazinë
9. Stacioni i pompave të ujit teknologjik
10. Salla e kompresorëve
11. Kabinë elektrike
12. Depo e ujit teknologjik
13. Dhoma e rojeve
14. Depo e lëndëve plasëse (Galeria 740)
15. Galeria 770 dhe sheshi

Shënim: Për pallatin e punëtorëve, ku bëhet rikonstruksioni i tij nga Fondacioni Hollandez Danida, sipas marrëveshjes me sh.a. Albkromin, është konsideruar se ai do të mbetet tani për tani në vartësi të sh.a. Albkromit. Me privatizimin e shoqërisë do të gjykohet për mënyrën e privatizimit të këtij pallati.

Sipërfaqja e vendburimit dhe zonës, që do të jepet në koncension për shfrytëzim dhe punimet e zbulim-kërkimit janë dhënë në planimetrinë në shkallë 1:5000 bashkëlidhur studimit.

VLERA LIGJORE E KAPITALIT E REGJISTRUAR NË GJYKATË DHE FUQIA PUNËTORE NË MARRËDHËNIE PUNE PËR SECILIN OBJEKT TË KONCESIONIT DHE NË TOTALE JANË:

A) VLERA E KAPITALIT	**659 545 294 Lekë**
- Uzina e Ferrokromit Elbasan	511 445 267 "
- Miniera e Kromit Prrenjas	92 361 398 "
- Miniera e Kromit Pojskë	55 738 629 "
B) NUMRI I PUNONJËSVE	**692**
- Uzina e Ferrokromit Elbasan	440
- Miniera e Kromit Prrenjas	202
- Miniera e Kromit Pojskë	50

ANEKSI NR.2

PROGRAMI I INVESTIMEVE SIPAS OBJEKTEVE NDARË NË FAZA

FAZA E PARË 12 MUAJ

1. UZINA E FERROKROMIT ELBASAN – investimi 2.065.827,00 EURO

Nr	Emërtimi	Karakteristikat	Sasia Copë
1	**Impianti i copëtimit**	- Kapaciteti 30-40 ton/orë - Granulometria 0-5, 5-30,30-50,50-100 mm	
	• Gurëthyesi i parë	- Goja e ushqimit 1500x1200 mm - Ushqimi i këshilluar 800-900 mm - Gjunjësa dyfishe - Xhirot e motorit 960 r/min - Fuqia e instaluar 160 kw - Hinka ushqyese 9 m3 - Ushqyes vibrues 1300x4550 mm	1
	• Gurëthyesi i dytë	- Goja e ushqimit 1030x830 mm - Ushqimi i këshilluar 400x500 mm - Gjunjësa dyfishe - Xhirot e motorit 960 r/min - Fuqia e motorit 80-120 kw - Hinka ushqyse 5 m3 - Ushqyes vibrues 1000x4550 mm	1
	• Thyesi	- Goja e ushqimit 800x225 mm - Gjunjësa e thjeshtë - Fuqia e motorit 50 kw - Ushqimi i këshilluar 150x200 mm	1
2	**Laboratori kimik**		1

	• Salla e përgatitjes së kampioneve	- Gurrëthyes 0-10 mm - Mulli HERZOG 100 # - Ndarës kampioni - Komplete sitash	1
	• Salla e analizave rruga e lëngshme	- Peshore elektronike Mettler 1/10.00 gr. - Furra elektrike për tharje kampioni - Pjastra elektrike për atakim acidi - Banjë rëre për atakim acidi - Furrë 8000 C për kalcinim komp. - Dejonizues rrëshire për ujin - Enë dhe reagente laboratori	1
	• Salla e instrumentave	- Aparat Leco për percaktim C dhe S - Absorber atomik për përcaktimin e: Cr, Mn, V, Pb, Ti, Ni, Ca, Al2O3, SiO2, Cr2O3, Fe, FeO, Cu, Mo, Mo, Zn, Co.	1
3	**Impianti i breiketimit**		
	• Hinkë ushqimi		1
	• Sitë vibruese		1
	• Elevator		1
	• Nxjerrës pneumatik		1
	• Skip ngarkimi		1
	• Përzjerës planetar		1
	• Transportjer shirit		1
	• Devijues elem.manjet		2
	• Hinkë ushqimi		1
	• Transportier shirit		1
	• Presë hidraulike komplete	- me forcë 800 tonë, me 21 forma	1
	• Grupi i largimit të copave		1
	• Tharës me gaz	- temp. tharje 250 0, koha 8-9 min.	1

2. MINIERA E KROMIT KATJEL – investimi 412.000 USD

Nr	Emërtimi	Karakteristikat	Sasia Copë
1	Kompresor	Deri 40 m3	1
2	Elektrovoz	10 tonë	1
3	Lopatë ngarkuese		3
4	Torno		1
5	Sondë nëntoke		1
6	Pompë uji	H – 200 m	2
7	Vagona miniere	0.86 m3	40
8	Ndërlidhje telefonike		1
9	Investim për ajrim dhe shpim të lagur		
10	Ofiçina dhe sallë kompresori		1
11	Kompjutera		2

12	Mana Vetëshkarkues	20 tonë	2
13	Autobusë për punëtorët		2

3. MINIERA E KROMIT POJSKË – investimi 122.548 USD

Nr	Emërtimi	Karakteristikat	Sasia Copë
1	Makinë transporti	20 tonë	1
2	Autobus	30 vendesh	1
3	Elektrovoz	3 ton	2
4	Tubacion për punime në horizont	¢ - 100 mm	4700 ml
5	Tubacione ajri	¢ - 76 mm	500 ml
6	Tubacioni ajri	¢ - 33 mm	500 ml
7	Linjë troleje		1250 ml
8	Motokompresor	Tip 10 m3	1
9	Vagone të kthyeshëm	0.75 m3	20
10	Shina	9 mm	1000 ml
11	Ventilator ajrimi		1
12	Kabëll elektrik	3x35+16	1500 ml
13	Transformator energjie	TN-TU 420 KV	1
14	Tubo ajrimi		300 ml
15	Shesh depozitimi stelilesh	Hor. 710	1
16	Rrugë për në bregun e pishës		2000 ml
17	Ndërlidhje radio-telefonike		1
18	Shpenzime kantieri në Bregun e Pishës		
19	Rikostruksion i tubacioneve të ajrit		

1. Kualifikimi i punonjësve
- Instruktimi për procesin e briketimit të pluhurave të mineralit
- Rikualifikim i punonjësve për sigurimin në punë.
- Rikualifikim për ciklin prodhues me aplikimin e sistemit të

INVESTIMI TOTAL I FAZËS SË PARË ËSHTË 2.600.375 EURO
PERIUDHA E INVESTIMIT 12 MUAJ
KAPACITETI NË FUND TË FAZËS SË PARË 20000 T/V FECR

FAZA E DYTË 12 MUAJ

1.UZINA E FERROKROMIT ELBASAN – investimi 5.681.025,890 EURO

Nr	Emërtimi	Karakteristikat	Sasia Copë
1	• Transformator	- Fuqia 13.8 KVA - Tensioni në primar 10000 V - Tensioni në sekondar 85-160 V - Shkallë tensioni 21 - Rryma në sekondar 50000 A	1
2	Tapatriçe komplet për metalin dhe skorjen		2
3	Impiant ftohës komplet për furrën, transformatorin, zbarat dhe pllakat, kroxholi i furrës etj.	- Tip Baltimor, përbëhet nga 2 pompa (njëra rezervë), vaska e grumbullimit dhe e zbutjes së ujit.	1
4	Impiant i thithjes së gazeve komplet	- Tip Flackt-Italian, 70000 m3/orë i pajisur me filtër me mëngë.	1
5	Ngarkuesit dhe peshorja		1
6	Punë ndërtimi dhe shërbime		

1. Kualifikimi i punonjësve
- Instruktimi për aplikimin e teknologjisë me nivele të dyfishta.
- Instruktim për përdorimin e sistemit të ventilimit të furrave dhe mjedisit rrethues.

INVESTIMI TOTAL I FAZËS SË DYTË ËSHTË 5.681.025,890 EURO
PERIUDHA E INVESTIMIT 12 MUAJ

FAZA E TRETË 2 VJET
(Për të diskutuar me OSHA, sidoqoftë kjo fazë nuk do të jetë më shumë se 2 vjet)

1. UZINA E FERROKROMIT ELBASAN – investimi 6.179.482,789 EURO

Nr	Emërtimi	Karakteristikat	Sasia Copë
1	Furrë TAGLIAFERRI	- Fuqia 14000 kw - Kapaciteti 73 ton/ditë, 25000 t/v	
	• Transformator	- fuqia 25000 KVA - Tensioni në primar 50000 V - Tensioni në sekondar 110-200 V - Rryma në sekondar 60000 A - Shkallët e tensionit 25	1
2	Tapatriçe komplet për metalin dhe skorjen		2
3	Impiant ftohës komplet		1
4	Impiant i thithjes së gazeve komplet	- kapacitet 130 –140000 m3 N/orë	1
5	Ngarkuesit dhe peshorja		1
6	Punë ndërtimi dhe shërbime		

DEKRET
Nr. 2564, datë 25.2.2000

PËR EMËRIMIN E ANËTARIT TË GJYKATËS KUSHTETUESE

Në mbështetje të neneve 125, pika 1, dhe 127, pika 3 të Kushtetutës, me pëlqim të Kuvendit dhënë me vendim nr.431, datë 23.2.2000,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Sabri Rrapi emërohet anëtar i Gjykatës Kushtetuese.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
Rexhep Meidani

DEKRET
Nr. 2586, datë 29.03.2000

PËR LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në Mbështetje të nenit 92, pika "c", të Kushtetutës, të neneve 15,19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 05.08.1998 "Për shtetësinë shqiptare", bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Rendit Publik,

DEKRETOJ:

Neni 1

U hiqet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Pjerin Marku Marku
2. Frederik Hasan Mehmeti
3. Mimoza Ymer Theymann (Ballushi)
4. Valmira Eqerem Bundo (Wormstall)
5. Teuta Dizdar Dizdari (Lohrum)
6. Ardian Dalip Stafa
7. Arben Gani Lika
8. Natalie Arben Lika
9. Dorian Arben Lika
10. Ingrid Estref Lika
11. Aishe Bejdo Karamani (Englhardt)
12. Besnik Dervish Isufi

13. Juna Ylli Tomorri
14. Roland Frano Malaj
15. Blendi Mevlan Dushollari
16. Adrian Hamza Domi
17. Kevin Adrian Domi
18. Annabell Adrian Domi
19. Edlira Xhevat Domi (Shahini)
20. Fatmir Sokol Blakçori

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
Rexhep Meidani

VENDIM
Nr.434, datë 1.3.2000

PËR SHQYRTIMIN ME PROCEDURË TË PËRSHPEJTUAR TË PROJEKTLIGJIT "PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR.8433, DATË 21.12.1998 "PËR PËRCAKTIMIN E FORMËS DHE STRUKTURËS SË FORMULËS TË PRIVATIZIMIT TË BANKËS TREGTARE SH.A.""

Në mbështetje të nenit 83 pika 2 të Kushtetutës dhe të nenit 105 dhe 107 të Rregullores së Kuvendit, me kërkesë të Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I :

I. Të shqyrtojë me procedurë të përshpejtuar projektligjin "Për disa shtesa në ligjin nr.8433, datë 21.12.1998 "Për përcaktimin e formës dhe të strukturës së formulës të privatizimit të Bankës Tregtare sh.a."".

II. Projektligji të shqyrtohet nga Komisioni i Përhershëm i Ligjeve dhe Çështjeve Kushtetuese dhe Komisioni i Përhershëm i Ekonomisë, Financave dhe Privatizimit deri më datën 6.3.2000 dhe miratimi i tij të bëhet në seancën plenare të datës 9.3.2000.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Skënder Gjinushi

VENDIM
Nr. 435, datë 20.3.2000

PËR CAKTIMIN E DEPUTETËVE QË DO TË MARRIN PJESË NË KOMISIONIN PËR DEKLARIMIN E PASURIVE TË TË ZGJEDHURVE DHE TË DISA DREJTUESVE E PUNONJËSVE TË SHËRBIMIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 7 të ligjit nr.7903, datë 8.3.1995 "Për deklarimin e pasurive të të zgjedhurve dhe të disa drejtuesve dhe punonjësve të shërbimit publik" dhe të nenit 88 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:

I. Në përbërje të Komisionit për Deklarimin e Pasurive të të Zgjedhurve dhe të disa Drejtuesve dhe Punonjësve të Shërbimit Publik të jenë deputetët:

1. Luan Shahollari(PS)
2. Zamira Caka(PS)
3. Engjëll Bejtaj(PSD)
4. Myslym Murrizi(PD)

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Skënder Gjinushi

VENDIM
Nr. 436, datë 30.3.2000

PËR ZGJEDHJEN E KOMISIONERËVE PRANË AVOKATIT TË POPULLIT

Në mbështetje të nenit 33 të ligjit nr.8454, datë 11.2.1999 "Për Avokatin e Popullit" dhe të neneve 88 dhe 92 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Avokatit të Popullit

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:

I. Të zgjidhet në detyrën e Komisionerit pranë Avokatit të Popullit zoti Agron Ismail Çaushi.

II. Të zgjidhet në detyrën e Komisionerit pranë Avokatit të Popullit zonja Florina Kozma Nuni (Tegu).

III. Të zgjidhet në detyrën e Komisionerit pranë Avokatit të Popullit zoti Jorgo Thanas Dhrami.

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Skënder Gjinushi

VENDIM
Nr. 102, datë 9.3.2000

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 160, DATË 9.7.1975, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR NORMAT E FURNIZIMIT TË USHQIMIT NË USHTRI"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 48, 49, të ligjit nr. 7527, datë 11.12.1991, "Për shërbimin ushtarak në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 160, datë 9.7.1975, të Këshillit të Ministrave, "Për normat e furnizimit të ushqimit në ushtri", bëhet ky ndryshim:

Pas pakës 4 shtohet pika 4/a, me këtë përmbajtje:

"Me normën e ushqimin nr.4 furnizohen dhe trajtohen efektivat ushtare, të cilat trajtoheshin me normën e ushqimit nr.2.".

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga ky vendim, të përballohen nga të ardhurat që Ministria e Mbrojtjes do të sigurojë në marrëdhëniet me të tretët.

3. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

KËRKESË

GJYKATËS SË RRETHIT TIRANË

KËRKUESE: NEXHMIE MEMA, e bija e Hasanit, lindur në Korçë më 1953 dhe banuese në rrugën "Mihal Grameno", pall.40, shkalla 1, apartamenti 2, Tiranë.

OBJEKTI: Shpalljen të zhdukur të bashkëshortit tim, Pëllumb Mema, lindur në Tiranë, më 06.04.1951, në bazë të neneve 15, e vijues të Kodit Civil dhe 375 e vijues të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

Sikurse rezulton nga çertifikata familjare Nr.L 1-32 datë 19.5.1999 jam bashkëshortja e Pëllumb Memës. Nga martesa nuk kemi fëmijë.

Në vitin 1991, bashkëshorti im është larguar për në Greqi sikurse mijëra shqiptarë të tjerë.

Që nga ajo kohë e deri më sot nuk kam patur asnjë komunikim me të dhe nuk di asgjë për fatin e tij, ndonëse gjatë kohës që jetonim në Tiranë kemi patur marrëdhënie shumë të mira. Kam bërë përpjekje me anën e njerëzve të mij që janë punësuar e jetojnë në Greqi, për të marrë ndonjë lajm, por nuk kam mundur.

Në datën 11 shtator 1997 në Nr.182(935) të gazetës Republika është shkruajtur një artikull me titullin: "Ka vrarë dhe djegur dy refugjatë shqiptarë, arrestohet nga policia", në të cilin thuhet se i arrestuari Skënder Balla, banues në fshatin Qerret të Durësit, kishte deponuar se në vitin 1991, kishte vrarë në fshatin Koropi të Athinës djemtë Pëllumb Mema e Sabit Korreshi. U interesova për këtë problem pranë prokurorisë së Durrësit, por më thanë se i arrestuari i kishte hedhur poshtë ato pohime në prokurori dhe më vonë ishte liruar për mungesë provash. Megjithë interesimin e njerëzve të mij në Greqi nuk kam mundur të marr asnjë lajm tjetër rreth bashkëshortit tim.

Në këto kushte, kërkoj që të deklarohet i zhdukur bashkëshorti im Pëllumb Mema, që më vonë të ndjek procedurat ligjore për shpalljen e tij të vdekur.

KËRKUESJA
Nexhmie Mema

U dorëzua për shtyp më 11.4.2000
Doli nga shtypi më 12.4.2000

Tirazhi: 3700 copë	Formati: 60x88/8

Shtypshkronja "Tipografia Ushtarake"

Çmimi: 150 lekë